




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo




Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

Raporti i Auditimit të Performancës

# BARAZIA GJINORE DHE FUQIZIMI I GRAVE NGA ZONAT RURALE PËRMES PËRFSHIRJES SË TYRE NË TREGUN E PUNËS



Prishtinë, Mars 2024



---

Publikimi i këtij raporti është mbështetur nga UN Women në kuadër të programit regional  
“Financimi Transformativ për Barazi Gjinore në Ballkanin Perëndimor” i financuar nga Sida.

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, të cilit Kushtetua dhe Ligji<sup>1</sup> i garantojnë pavarësi funksionale, financiare dhe operative.

Zyra Kombëtare e Auditimit, që kryesohet nga Auditori i Përgjithshëm, e ndihmon në kryerjen e detyrave të tij/saj. Së bashku kontribuojnë në mënyrë efektive në llogaridhënien e sektorit publik, duke promovuar transparencën publike dhe qeverisjen e mirë, dhe duke nxitur ekonominë, efektivitetin dhe efikasitetin e programeve qeveritare për të mirën e të gjithëve. Auditori i Përgjithshëm i jep llogari Kuvendit për ushtrimin e detyrave dhe kompetencave të përcaktuara në Kushtetutë, në Ligj, në aktet nënligjore dhe në standardet ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare. Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA 3000)<sup>2</sup>.

Auditimet e performancës të ndërmarra nga Zyra Kombëtare e Auditimit janë shqyrtime objektive dhe të besueshme që vlerësojnë nëse veprimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat veprojnë në përputhje me parimet e ekonomisë<sup>3</sup>, efikasitetit<sup>4</sup> dhe efektivitetit<sup>5</sup> dhe nëse ka vend për përmirësim.

Auditorja e Përgjithshme ka vendosur në lidhje me përmbajtjen e raportit të auditimit të performancës "Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale përmes përfshirjes së tyre në tregun e punës", në konsultim me Ndhmës Auditoren e Përgjithshme, Myrvete Gashi Morina, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Ekipi që realizoi këtë raport:

Ariana Gjonbalaj Shala, Drejtor i Departamentit të Auditimit

Ardiana Miftari, Udhëheqëse e Ekipit

Ylfete Osmani, Anëtare e Ekipit

Arlinda Mustafa, Anëtare e Ekipit

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT - Adresa: Lagjja Arbëria, Rr. Ahmet Krasniqi 210, Prishtinë 10000, Kosovë

Tel: +381(0) 38 60 60 04/1011

1 Ligji 05\_L\_055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës

2 Standardet dhe udhëzimet për auditimin e performancës bazuar në Standardet e Auditimit të ONISA-s

3 2 Ekonomia - Parimi i ekonomisë nënkupton minimizimin e kostos së burimeve. Burimet e përdorura duhet të jenë në dispozicion në kohën e duhur, në sasinë dhe cilësinë e duhur dhe në çmimin më të mirë të mundshëm.

4 Efikasiteti - Parimi i efikasitetit nënkupton marrjen e maksimumit nga burimet në dispozicion. Ka të bëjë me lidhjen mes burimeve të përfshira dhe rezultatit të dhënë në aspektin e sasisë, cilësisë dhe kohës.

5 Efektiviteti - Parimi i efektivitetit nënkupton arritjen e objektivave të paracaktuara dhe arritjen e rezultateve të pritshme.

# Tabela e përmbajtjes

<b>Përmbledhje e përgjithshme</b> .....	<b>1</b>
<b>1.Hyrje</b> .....	<b>4</b>
<b>2.Objektiva dhe pyetjet e auditimit</b> .....	<b>8</b>
<b>Pyetjet e auditimit</b> .....	<b>8</b>
<b>3.Gjetjet e auditimit</b> .....	<b>12</b>
<b>3.1.Vlerësimi i kriterëve, informimi publik dhe monitorimi i programit të granteve nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural</b> .....	<b>14</b>
3.1.1. <i>Kriteret e përzgjedhjes nuk sigurojnë përkrahjen e barazisë gjinore</i> .....	14
3.1.2. <i>Mos përfshirja e grave rreth informimit për Programet e Zhvillimit Rural</i> .....	17
3.1.3. <i>Mangësi në procesin e monitorimit të PZHR-ve</i> .....	19
<b>3.2.Shpallja e thirrjeve për aplikim, shqyrtimi i aplikacioneve dhe procesi i kontrollit të granteve nga Agjencia e Zhvillimit të Bujqësisë</b> .....	<b>20</b>
3.2.1. <i>Vonesa në shpalljen e thirrjeve për aplikim</i> .....	20
3.2.2. <i>Procedurat e regjistrimit dhe shqyrtimit të aplikimeve nuk e përkrahin mjaftueshëm gjininë femërore</i> .....	23
3.2.3. <i>Rritja e interesimit për disa nga sektorët e bujqësisë nuk e ka rritur edhe numrin e grave përfituese</i> .....	26
3.2.4. <i>Kushtëzimi i masave afirmative bënë të pa efektshëm qëllimin e tyre</i> .....	28
3.2.5. <i>Mangësi në procesin e kontrolleve të përfituesve të granteve</i> .....	31
<b>3.3.Regjistrimi i punëkërkueseve dhe profilet e aftësisë për gratë e zonave rurale nga Agjencia e Punësimit</b> .....	<b>35</b>
3.3.1. <i>Mungojnë të dhënat dhe shërbimet e aftësisë profesionale të ndara sipas zonave urbane dhe rurale</i> .....	35
<b>4.Konkluzionet</b> .....	<b>40</b>
<b>5.Rekomandimet</b> .....	<b>44</b>
<b>Shtojca 1. Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit</b> .....	<b>48</b>
<b>Shtojca 2. Analizat e kriterëve dhe numri i kontrolleve të përfituesëve</b> .....	<b>50</b>
<b>Shtojca 3. Raporti i anketës</b> .....	<b>54</b>
<b>Shtojca 4. Letër konfirmimi dhe komentet e entitetit</b> .....	<b>84</b>

# Lista e shkurtesave

<b>AM</b>	Autoritet Menaxhues
<b>APRK</b>	Agjencia e punësimit e Republikës së Kosovës
<b>ASK</b>	Agjencia e Statistikave të Kosovës
<b>AZHB</b>	Agjencia për Zhvillim të Bujqësisë
<b>MBPZHR</b>	Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
<b>PBZHR</b>	Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
<b>PKBGJ</b>	Programi i Kosovës për Barazi Gjinore
<b>LBGJ</b>	Ligji për Barazi Gjinore
<b>PZHR</b>	Programi për Zhvillim Rural
<b>IPA</b>	Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim Rural
<b>IPARD</b>	Programi Ndërkombëtar për Zhvillim Rural
<b>KBGJ</b>	Komiteti për Barazi Gjinore
<b>MFPT</b>	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
<b>KDI</b>	Instituti Demokratik i Kosovës
<b>UA</b>	Udhëzim Administrativ
<b>DSHK&amp;T</b>	Departamentin i shërbimeve këshillimore dhe Teknike
<b>QAP</b>	Qendrat e Aftësimit Profesional



# Përmbledhje e përgjithshme

Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer auditimin e performancës “Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale përmes përfshirjes së tyre në tregun e punës”. Objektivi e këtij auditimi ishte vlerësimi i efektivitetit dhe ndikimit të politikave, programeve dhe masave që synojnë promovimin e përfshirjes së grave nga zonat rurale në tregun e punës, me fokus në rritjen e pjesëmarrjes së tyre dhe identifikimin e mundësive për përmirësim.

Fokus i këtij auditimi ishin Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural si përgjegjëse për hartimin e Programit për Zhvillim Rural, Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë si zbatuese e këtij programi, si dhe Agjencinë e Punësimit si përgjegjëse për administrimin e tregut të punës dhe zbatimin e politikave të punësimit dhe aftësimin profesional në Kosovë. Ky auditim ka përfshirë periudhën 2019-2023 dhe është fokusuar në ndikimin e programeve dhe masave për përfshirjen e grave nga zonat rurale në tregun e punës.

Konkluzioni i auditimit tregon se ende nuk janë arritur rezultate të kënaqshme për fuqizimin e gruas dhe sidomos përfshirjen e grave nga zonat rurale në tregun e punës. Programet e Zhvillimit Rural, të parapara për fuqizimin e grave në tregun e punës, dhe përcaktimi i masave afirmative për këtë qëllim nuk kanë arritur të sigurojnë një përkrahje të barabartë për të dy gjinitë. Nuk ka një vlerësim sistematik institucional për menaxhim të projekteve në bazë gjinore apo rreth arritjes së qëllimeve të programit nga kjo perspektivë.

**Programet për Zhvillim Rural nuk janë hartuar dhe aprovuar me kohë.** Të gjitha thirrjet për aplikim për fermerë dhe ekonomi familjare gjatë periudhës 2019-2022 janë bërë në pjesën e dytë të vitit, ndërsa shpallja për vitin 2023 është bërë në fund të këtij viti. Vonesat në hartimin dhe aprovimin e Programeve kanë ndikuar në mënyrë zingjirë edhe në vonesa tjera siç janë: vonesa në shpalljen e thirrjeve për aplikim si dhe në përzgjedhjen e përfituesve të granteve.

**Masat aktuale afirmative nuk janë efektive për të mbështetur gratë në zonat rurale.** Kushtëzimi i masës afirmative me tre deri në pesë vite si pronare e tokës apo e biznesit, e ka bërë të pa efektshëm qëllimin e tyre për shkak se kufizon pjesëmarrjen apo përkrahjen e grave dhe vajzave të cilat kanë filluar aktivitetin e tyre rishtazi. Megjithatë problemet e pronësisë janë dukshëm më të shprehura te gjinia femërore, mos zbatimi i masës afirmative rrit numrin e të refuzuarave nga gjinia femërore. Po ashtu, kriteret e përzgjedhjes nuk sigurojnë pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e barabartë të gjinisë femërore në përfitimin e granteve përmes programit për zhvillim rural. Kriteret e përzgjedhjes me bazë gjinore implikohen nga kriteret tjera duke ndikuar negativisht në nivelin e grave përfituese.

**Janë identifikuar mangësi në monitorim dhe mbikëqyrje për përfituesit e granteve.** Në raportet e monitorimit mungojnë të dhënat e ndara sipas gjinisë dhe procedurat administrative, rotacioni i inspektorëve nuk realizohet vazhdimisht siç duhet, duke lejuar që çështjet si moszbatimi i kriterëve për të punësuarit apo hapja e vendeve të reja të punës të mos mund të verifikohet siç është paraparë në

projekt. Mungesa e një Komiteti Monitorues funksional që nga viti 2014 dhe mangësitë në procesin e emërimit të inspektorëve ka rezultuar me mungesë të të dhënave për të pasqyruar rezultatet e arritura apo ndikimin e tyre në përfshirjen e grave nga zonat rurale në tregun e punës.

**Mangësitë e informacionit dhe pengesat e komunikimit.** Mungesa e informacionit specifik gjinor për aplikantët për grante kontribuojnë në pengesat në hartimin e politikave. Mos informimi i grave në zonat rurale lidhur me mundësinë e përfitimit të granteve ndikojnë në nivelin e ulët të përfshirjes së tyre.

**Agjencia e punësimit nuk posedon të dhëna të ndara në baza gjinore, sipas zonave urbane dhe rurale.** Agjencia e Punësimit nuk ka një pasqyrë të qartë për gjendjen dhe nevojat e grave nga zonat rurale. Mungesa e këtyre të dhënave krijon paqartësi për grupet e interesit në aspektin e njohjes së nevojave dhe planifikimin e zgjerimit të tregut në favor të barazisë gjinore. Kurse dështimi për të komunikuar në mënyrë efektive informacionin, veçanërisht në lidhje me trajnimin profesional për gratë fermere, kufizon përfshirjen e tyre në tregun e punës.

Gjetjet e auditimit tregojnë se çështjet që kanë të bëjnë me ndikimin e politikave, programeve dhe masave që synojnë promovimin e përfshirjes së grave nga zonat rurale në tregun e punës kërkojnë përmirësim dhe për këtë janë dhënë 10 rekomandime. Lista e rekomandimeve është paraqitur në Kapitullin 5 të këtij raporti.

#### **Përgjigja e palëve të përfshira në auditim**

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural si dhe Agjencioni për Zhvillim të Bujqësisë janë pajtuar pjesërisht me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, këto komente i gjeni në shtojcën IV, si dhe janë zotuar se do t'i adresojnë të gjitha rekomandimet e dhëna. Poashtu, edhe Agjencioni i Punës është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit dhe janë zotuar se do t'i adresojnë të gjitha rekomandimet e dhëna.



---

**HYRJE**


**01**

# 1. Hyrje

Barazia gjinore është vlerë themelore e zhvillimit demokratik të vendit, e cila ka ndikim kyç në zhvillimin ekonomik dhe social të shoqërisë. Në mënyrë që të arrihet e drejta e barazisë gjinore, kjo e drejtë duhet të njihet me ligj dhe të zbatohet në jetën shoqërore, politike, ekonomike dhe kulturore. Parimi i barazisë gjinore në kornizën ligjore dhe institucionale të vendit tonë pasqyrohet në Kushtetutën e Kosovës, Ligjin për Barazi Gjinore dhe ligjet e tjera të Kosovës duke u bazuar në konventa rajonale si Karta Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Konventa e Këshillit të Evropës kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, si dhe konventa ndërkombëtare për të drejtat e grave.<sup>6</sup>

Megjithëse në Kosovë korniza ligjore është mjaft e avancuar për të siguruar dhe garantuar barazi gjinore, dhe janë miratuar politika publike nga Qeveria siç është Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024 (tutje PKBGJ), në praktikë barazia gjinore ende mbetet një standard i paarritur ku gratë janë të nën përfaqësuar në shumë sfera të shoqërisë si vendimmarrje, punësim dhe sfera tjera shoqërore. Gratë vazhdojnë të diskriminohen në punësim ku pjesëmarrja e tyre në tregun e punës vazhdon të mbetet më e ulëta në krahasim me vendet e tjera të rajonit. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës gjatë vitit 2022, përqindja e të punësuarve nga gjinia mashkullore ishte 47% ndërsa nga gjinia femërore vetëm 18%.<sup>7</sup> Në figurën e mëposhtme kemi paraqitur treguesit e fuqisë punëtore të tremujorëve të parë për periudhën 2019-2022 sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës.

**Grafiku 1: Treguesit e fuqisë punëtore sipas gjinisë në Kosovë**



Burimi: Te dhënat e marra nga ASK, Anketa e fuqisë punëtore TM1, 2019 2020,2021 dhe 2022

6 Konventa për eliminimin e te gjitha formave te diskriminimit ndaj grave CEDAW

7 Anketa e Fuqisë Punëtore (AFP), TM1 2022

Megjithëse, papunësia ka vazhduar të bie nga viti 2019 në vitin 2022, tregu i punës karakterizohet me shkallë të lartë të pasivitetit, që sipas figurës vërehet që 77% e grave nuk kërkojnë punë fare. Niveli i hendekut të krijuar te gratë e papuna dhe joaktive në tregun e punës është për arsye që ato vazhdojnë të përballen me sfida që rrjedhin nga shoqëria, por edhe si pasojë e mungesës së veprimeve institucionale për të parandaluar apo ndryshuar situatën. Përmirësimi i pjesëmarrjes së grave në nivel vendi në tregun e punës duhet të jetë prioritet i lartë jo vetëm për shkak të barazisë, por edhe për shkak të ndikimit pozitiv ekonomik për vendin në përgjithësi.

Gratë janë të nën përfaqësuar në sektorin e bujqësisë për shkak të fuqisë punëtore të paregjistruar, mungesë pronësie, nivelit të ulët arsimor si dhe mungesës së informimit/edukimit të tyre.<sup>8</sup> Përqindja e grave në Kosovë që punojnë në bujqësi dhe agrobiznes, është afërsisht sa e burrave, por rezultatet e punës së tyre janë pak të evidentuara, sepse punësimi i tyre në këtë fushë nuk formalizohet. Rezultate të ngjashme janë paraqitur edhe në raporte tjera ku theks të veçantë kanë gratë të cilat jetojnë në zonat rurale e të cilat kanë më pak gjasa që të marrin pjesë në tregun e punës në krahasim me gratë që jetojnë në zonat urbane.

Sa i përket zhvillimit të bizneseve rurale dhe diversifikimit ekonomik, ndërhyrja më e rëndësishme publike është skema e granteve të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (tutje MBPZHR). MBPZHR përmes programit për bujqësi dhe zhvillim rural ka hartuar disa politika favorizuese/masa afirmative për gratë në mënyrë që të përkrahët punësimi i grave nga zonat rurale dhe fuqizimi i tyre në bizneset bujqësore.

Në tabelën në vijim janë paraqitur të dhënat për numrin e grave përfituese si dhe buxhetin e shpenzuar për financimin e projekteve të tyre përmes Programit për Zhvillim Rural (tutje PZHR), për periudhën 2019-2022.

**Tabela 1: Numri i përfituesve dhe buxheti i shpenzuar për projektet e kontraktuara përmes PZHR-së, për periudhën 2019-2022<sup>9</sup>**

Viti	Total numri i përfituesve	Numri i granteve të ndara për gra	Numri i granteve të ndara për burra	Total buxheti i kontraktuar për gra dhe burra	Buxheti i kontraktuar për gra	Buxheti i kontraktuar për burra
2019	499	216	283	16,433,590	7,395,115	9,038,474
2020/21	343	130	213	12,627,799	4,798,563	7,829,235
2022	495	145	350	24,163,827	7,249,148	16,914,678

Burimi: AZHB, [www.azhb-ks.net](http://www.azhb-ks.net).

Siç mund të vërehet nga tabela, se nga numri i përgjithshëm i përftuesve për grantet e ndara përmes PZHR-së, numri i grave përfituese është më i vogël në krahasim me përftuesit burra. Kështu që përfituese

8 Raporti i Rrjetit të Grave të Kosovës

9 Raport përmbljedhës "Gratë në bujqësi dhe aktivitetet rurale" MBPZHR

gra gjatë vitit 2019 janë 43%, në vitin 2020/21 rreth 38%, ndërsa në vitin 2022 numri i grave përfituese ka rënë në rreth 30%.

Këta indikator na japin të kuptojmë se zbutja e papunësisë së grave nga zonat rurale përmes granteve të ministrisë është në nivel të ultë. Kurse rol vendimtar në këtë aspekt ka edhe Agjencia e Punësimit.

---

# OBJEKTIVA DHE PYETJET E AUDITIMIT

# 02

## 2. Objektiva dhe pyetjet e auditimit

Objektivë e këtij auditimi është që të vlerësojmë efektivitetin dhe ndikimin e politikave, programeve dhe masave që synojnë promovimin e përfshirjes së grave nga zonat rurale në tregun e punës, me fokus në rritjen e pjesëmarrjes së tyre dhe identifikimin e mundësive për përmirësim.

Përmes këtij auditimi do të synojmë dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e sistemit në fushën e caktuar të auditimit.

### Pyetjet e auditimit

Për t'iu përgjigjur objektivës së auditimit janë parashtruar pyetjet si në vijim:

1. *A kanë zbatuar në mënyrë të duhur institucionet kompetente programet dhe a kanë ndikuar masat afirmative për zhvillim rural në perspektivën gjinore?*
2. *A monitorohen masat dhe programet për të vlerësuar ndikimin e tyre në përfshirjen e grave nga zonat rurale në tregun e punës, arritjen e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave?*

Ky auditim ka përfshirë periudhën 2019-2023 dhe është fokusuar në ndikimin e programeve dhe masave për përfshirjen e grave nga zonat rurale në tregun e punës.

Auditimi është kryer në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB), si dhe Agjencinë e Punësimit (APRK), ku fokus kryesor ka qenë Programi për bujqësi dhe zhvillim rural, përkatësisht dy masat si në vijim:

- a. *Investimet në pasuritë fizike në ekonominë bujqësore- përqendrohet në përkrahjen e investimeve në këta sektorë: pemë, perime (përfshirë patatet), qumësht, mish, rrush dhe vezë.*
- b. *Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i biznesit- mbështetë një varg aktiviteteve bujqësore dhe jo-bujqësore përmes sektorëve siç janë: artizanalet, zhvillimi i turizmit rural, prodhimtaria e mjaltit, produktet jo drusore, akuakultura dhe rritja e shpezëve.*

Përzgjedhja e këtyre dy masave është bërë për faktin se përmes tyre, gratë fermere kanë përparësi në përfitimin e granteve investive duke u vlerësuar me pika shtesë.

Ky auditim ka lidhje të drejtpërdrejtë me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030 të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim të Qëndrueshëm, ku barazia gjinore është një prej temave qendrore të kësaj agjende.

Auditimi është zhvilluar në mënyrë paralele me shtetet fqinje dhe mbështetet në Marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet përfaqësuesve të Entit Shtetëror të Revizionit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kontrollit të Lartë të Shtetit të Shqipërisë si dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit në Kosovë. Marrëveshja është në përputhje me Udhëzuesin 9000 të INTOSAI-t, dhe në mbështetje të Agjencisë së Kombeve të Bashkuara – UN Women.

Metodologjia dhe fushëveprimi i auditimit janë paraqitur në Shtojcën 1.





---

# GJETJET E AUDITIMIT

# 03

### 3. Gjetjet e auditimit

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (tutje MBPZHR) bën hartimin e politikave afatgjata dhe aftashkurtëra duke hartuar dokumente strategjike si; draft Programin shtatë vjeçar për Bujqësi dhe Zhvillim Rural për periudhën 2014-2020, Strategjinë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022-2028, si dhe Programin Kombëtar për Bujqësi dhe Zhvillim Rural për periudhën 2023-2027.

Në bazë të këtyre programeve hartohen programet një vjeçare për zhvillim rural ku duhet të përcaktohen masat dhe nën-masat për financim si dhe planifikimi buxhetor.

Përcaktimi i kriterëve për poentim të masave duhet të zbatohet në bazë të analizave konkrete vlerësuese dhe përmes udhëzuesit administrativ. Pikët për kriteret e përzgjedhjes përcaktohen për secilin nën sektorë të masave të financuara nga ministria.<sup>10</sup>

Ministria e Bujqësisë duhet të përcaktoj kornizën e vlerësimit përmes identifikimit të indikatorëve të performancës për të bërë një vlerësim të programit të zhvillimit rural. Ministria duhet të ndërmarr të gjitha masat për t'u dhënë grave një mundësi të barabartë dhe reale për qasje dhe përfitim nga fondet e ministrisë përmes veprimeve afirmative<sup>11</sup>, zbatimit të obligimeve të parapara në Ligjin për barazi gjinore<sup>12</sup> dhe PKBGJ si dhe duke respektuar të drejta të plota të çdo individit<sup>13</sup>.

Për promovimin dhe informimin e fermerëve dhe palëve tjera të interesit rreth programit për zhvillim rural, çdo vit Autoriteti Menaxhues në bashkëpunim me AZHB duhet të zhvillojë sesione informuese, me qëllim që fermerët dhe publiku i gjerë të jetë i informuar me kohë.

MBPZHR duhet të hartoj dhe përditësoj kornizën monitoruese dhe vlerësuese për zbatimin e dokumenteve të politikave të zhvillimit rural.<sup>14</sup>

Thirrja publike për përfitim të granteve në zonat rurale, ekzekutimi dhe kontrolli i projekteve bëhet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, si përgjegjëse për zbatimin e programit për zhvillim rural. Kjo agjenci bën shpalljen e thirrjes publike për aplikim për fermerët dhe ekonomitë bujqësore. Thirrja publike për aplikim mbetet e hapur 30 ditë apo në disa raste me vendim të Ministrit edhe 45 ditë.

10 Udhëzuesit administrative 2019,2020,2021

11 Sipas strategjisë për bujqësi dhe zhvillim rural veprime afirmative nënkupton dhënien e pikëve më të larta dhe mundësi të barabarta për qasje dhe pagesa direkte

12 Ligji për Barazi gjinore, Neni 5 pika 1.5.Përfshirja e buxhetimit gjinor në të gjitha fushat, si një instrument i nevojshëm për të garantuar që parimi i barazisë gjinore respektohet në mbledhjen, shpërndarjen dhe caktimin e burimeve

13 Strategjia për bujqësi dhe zhvillim rural 2022-2028, pika 5.4.4 Barazia gjinore dhe përfshirja sociale

14 Rregullore e brendshme neni 11. Pika 1.1

Pas shpalljes së thirrjes për aplikim, detyrë e departamenteve të AZHB-së është të pranojnë dokumentet përmes sistemit on-line sipas masave dhe sektorëve të shpallur në thirrjen publike. Departamentet shqyrtojnë aplikacionet dhe verifikojnë plotësimin e kriterëve të përputhshmërisë.<sup>15</sup>

Për të vërtetuar gjendjen reale, AZHB duhet të realizoj tri kontrole në terren, kontrolli i parë, kontrolli i dytë dhe ex-post kontrolla.

Regjistrimin e punëkërkesve dhe ofrimin e shërbimeve të aftësisë profesionale e bën Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës. Një ndër objektivat kryesore strategjike të Shërbimeve Publike të Punësimit në Kosovë është ulja e inaktivitetit, rritja e punësimit, zhvillimi i shkathësive në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe administrimi më i mirë i tregut të punës.

Pyetjeve të këtij raporti të auditimit, i janë përgjigjur edhe gratë e zonave rurale përmes një ankete të realizuar në shtatë regjionet e Kosovës. Kjo anketë është zhvilluar në bazë të Marrëveshjes së bashkëpunimit nga Agjencia e Kombeve të Bashkuara përkatësisht zyra përfaqësuese "UN Women" në Kosovë. Anketa ka përfshirë 400 gra dhe gjetjet e kësaj ankete janë me nivel besimi prej 95% dhe marzhë të gabimit prej 4.89%. Mostra është e stratifikuar sipas regjioneve dhe e përzgjedhur me metodë të rastit (për më shumë detaje, shih anketën në Shtojcën 3).

Anketa kishte për qëllim: për të matur angazhimin e grave në tregun e punës, qasjen në pronë, qasjen në informacione për grantet e MBPZHR-së, aplikimin për grante në MPBZHR dhe përvojën e tyre si dhe qasjen në shërbimet këshilluese për bujqësi.

Mostra prej 400 grave që jetojnë në zonat rurale në Kosovë shfaq një shpërndarje proporcionale sipas popullsisë së grave në zonat rurale në shtatë rajonet e Kosovës.

**Figura.1. Të anketuarat sipas rajonit**



15 Rregullorja e punës së AZHB-se, 2012

Më poshtë janë paraqitur gjetjet të cilat janë rezultat i analizimit dhe vlerësimit të dokumentacionit, auditimit të proceseve, testimëve, intervistave me zyrtarë përgjegjës në terren si dhe anketës. Dëshmitë e mbledhura kanë shërbyer në dhënien e konkluzioneve të cilat janë paraqitur në Kapitullin 4 dhe rekomandimeve për përmirësimin e proceseve të cilat janë paraqitur në Kapitullin 5.

### 3.1. Vlerësimi i kriterëve, informimi publik dhe monitorimi i programit të granteve nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Në këtë kapitull janë përfshirë gjetjet që kanë të bëjnë me vlerësimin e kriterëve për masat dhe nën-masat e programit për zhvillimin rural, mënyrën e shpërndarjes së informacionit tek përfituesit e mundshëm si dhe procedurat dhe metodat e monitorimit të programit për të siguruar që implementimi dhe rezultatet janë në përputhje me qëllimet e programit për zhvillim rural.

#### 3.1.1. Kriteret e përzgjedhjes nuk sigurojnë përkrahjen e barazisë gjinore

**Ministria e Bujqësisë duhet të përcaktoj kornizën e vlerësimit përmes identifikimit të indikatorëve të performancës për të bërë një vlerësim të programit të zhvillimit rural<sup>16</sup>.**

Programet e zhvillimit rural vlerësohen dhe monitorohen nga Komisioni Evropian në përputhje me rregullat dhe procedurat e Agjencisë Ndërkombëtare për Zhvillim Rural (IPA)<sup>17</sup> Këto vlerësime zhvillohen në tri faza; vlerësimet paraprake (ex-ante), afat mesme (mid term) dhe përfundimtare (ex-post).<sup>18</sup>

Është vërejtur se për Programin Kombëtar të MBPZHR-së 2014-2020 janë përfunduar dy vlerësime; ex ante dhe mid term<sup>19</sup>, gjithashtu ekziston një dokument i vlerësimit ex ante i përgatitur për programin strategjik 2023-2027.<sup>20</sup>

16 MBPZHR, Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit të Politikave të zhvillimit rural (Autoriteti Menaxhues), Divizioni për monitorim, vlerësim dhe raportim për zhvillim rural.

17 Marrëveshja kornizë e BE-së, 2015, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10774>

18 Manuali i monitorimit dhe vlerësimit, DMV

19 Ex post evaluation report 2013, Ex ante evaluation report 2014-2020, Mid term evaluation 2019

20 Ex ante evaluation report 2023

Sipas raportit afat mesëm të vlerësimit, të programit 2014-2020, masat afirmative të cilat konsiderohen si indikatorë socio ekonomik, duhet të realizohen përmes përfshirjes së kriterit për moshën dhe gjininë.<sup>21</sup> Duhet theksuar se sipas udhëzuesve të Programit Ndërkombëtar për Zhvillim Rural (IPARD), kriteret e përzgjedhjes dhe pikët vlerësuese për secilën nga thirrjet ndahen në bazë të propozimit të përgatitur nga Autoriteti Menaxhues dhe në bashkëpunim me Agjencinë IPA.<sup>22</sup>

Nëse i referohemi PZHR-ve vjetore dhe udhëzimeve administrative (tutje UA) vërehet se numri i kriterëve ka ndryshuar ndër vite.<sup>23</sup> Kriteret janë hequr apo shtuar si dhe janë poentuar me pikë të ndryshme varësisht nga programet dhe udhëzuesit vjetorë. Për ndryshimet në kriteret shih shtojcën 2. (Tabela 12. Ndryshimi i kriterëve të përzgjedhjes dhe notimi i tyre gjatë viteve).

Për të dyja masat një efekt të pamohueshëm ka pasur shpërndarja e pikëve. Në masën 1 “Investimet në asetet fizike dhe zhvillimi ekonomik” pikët afirmative janë kushtëzuar me verifikimin e pronësisë, kurse në masën 302/7 “Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve”, në disa sektorë ka pasur ndryshim të madh të pikëve afirmative për gjininë. Theksojmë se për masën 302/7 pikët kanë lëvizur në masë të madhe varësisht nga sektorët, në disa raste nga 55 në 5 pikë. Për shembull, pikët e parapara për sektorin e artizanaleve të cilat janë paraparë të avancojnë gjininë femërore ndër vite ka ndryshuar dhe implikuar me kriterin “Përvoja e fermerit” dhe “Aplikues i ri”, (Shih shtojcën 2. Tabelën 13. Ndryshimi i kriterëve për masën 302/7).

21 MTE, <https://www.developmentaid.org/organizations/awards/view/204041/support-to-the-ministry-of-agriculture-forestry-and-rural-development-mafrd-to-evaluate-the-agricult> Anex 3, Themes and questions for focus group discussions, August 2019.

22 Programming guidelines IPARD III, fq 3 Sectorial agreement for IPARD III

23 Për Masën 1 “Investimet në asetet fizike dhe zhvillimi ekonomik” janë aplikuar 9 deri 11 kriteret, kurse për Masën 302/7 “Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve” janë aplikuar 6 deri 11 kriteret

Për më shumë qartësi, më poshtë kemi pasqyruar ndryshimet e masave afirmative për të dyja masat.

**Tabela 2: Ndryshimet në kritere në programet vjetore të zhvillimit rural 2019-2023**

Ndryshimi i masave afirmative									
Masa 1- Investimet ne asetet fizike					Masa 7 - Diversifikimi fermave dhe zhvillimi i bizneseve				
Kriteri	Pikët maksimale afirmative dhe piket e kritereve më të ndërvarura				Kriteri	Pikët maksimale afirmative dhe piket e kritereve më të ndërvarura			
Vitet	2019	2020/21	2022	2023	Vitet	2019	2020/21	2022	2023
Gjinia e fermerit (Sektori serra & drufrutore)	2	2	2	2	Gjinia e fermerit (Turizmi rural/P. I majtit/ Artizanale)	2,2,55	2,2,10	5,5,5	5,10,5
Aplikues i ri (Sektori serra & drufrutore)			3	3	Mosha e aplikuesit (Turizmi rural/ Perpunimi I mjaltit/ Artizanalet)	5,5,10	5,5,10	5,5,35-45	10,5,35-45
Pronesia e tokes (Sektori serra& drufrutore)	.3,10	.3,10	.3,10	.3,10	Pervoja e aplikuesit (Turizmi rural dhe Artizanalet -mbi nje vjecare merr pike maksimale)	25-35,10-15	25-35,35-40	50-55,15	40-45,15

Pasqyra më lartë tregon ndryshimet në masat afirmative, ku kriteret socio ekonomike implikohen nga kriteret tjera. Për shembull: Aplikuesit gra tek masa 1 “Investimet në asetet fizike dhe zhvillimi ekonomik” do të marrin pikët afirmative vetëm nëse janë pronare të tokës për tre deri në pesë vitet e fundit. Aplikueset gra në masën 302/7 “Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve” i marrin pikët vetëm nëse dëshmojnë tre vite pronësi në biznese të hapura. Kjo do të thotë se pikët afirmative nuk kanë pasur ndikim në mbështetjen e drejtpërdrejtë të grave.

Në bazë të këtyre fakteve mund të përfundojmë se programet dhe masat e ndërmarra nuk sigurojnë fuqizimin e grave në zonat rurale.

Ndërmarrja e masave nga autoritetet e ministrisë për kushtëzimin e masës afirmative në emër të evitimit të “kushteve artificiale”<sup>24</sup> nuk ka ndonjë bazë reale të vlerësimit. Në anën tjetër, pavarësisht gjinisë së aplikuesit grantet janë të parapara si financim i bizneseve familjare dhe projektet bujqësore

<sup>24</sup> Sipas PZHR, Krijimi i kushteve artificiale nënkupton marrjen e pikëve në emër të gjinisë, kjo paraqet mashtrim dhe ndeshkohet sipas legjisllacion ne fuqi

mund të menaxhohen vetëm duke u përfshirë të dyja gjinitë. Kjo nënkupton se më e rëndësishme është mbikëqyrja apo realizimi i projektit dhe jo nga kush e menaxhohet projekti.

Pasojat negative të procedurave vazhdimisht të ndryshueshme të kritereve dhe poentimit vërehen në dy aspekte: E para, meqenëse në Kosovë moshat e grave që merren me bujqësi është kryesisht 45-55 vjeç, përfitimi i pikëve si fermer i ri ka stimuluar moshat e reja por ka përjashtuar gratë fermere<sup>25</sup>, sepse ato nuk hyjnë në kategorinë "fermer i ri". E dyta, gratë në gjithë Kosovën gëzojnë pronësinë e paluajtshme në vetëm 17% të pronave dhe për tokat bujqësore kjo përqindje mezi arrin në 4%, prandaj kushtëzimi i masës me pronën e paluajtshme ka përjashtuar shumë më tepër gra se burra.<sup>26</sup> Ndërkaq, ulja e pikëve afirmative tek disa nga sektorët e masës 7/302 e në veçanti atyre artizanale ka rritur numrin e përfituesve burra që për vitet 2019-2022 arrin shifrën 45-55% të përfituesve. Kjo tregon se edhe sektorët që janë paraparë të ndihmojnë përfshirjen e grave në tregun e punës janë dukshëm larg këtij qëllimi.

Vlen të ceket se, sipas autoriteteve, kushtëzimi i masës afirmative me pronësinë mbi patundshmëri ka pasur për qëllim rritjen e numrit të grave që kanë këtë të drejtë. Sipas legjislacionit grave ju takon e drejta pronësore në bazë të lidhjes familjare dhe kjo ju mundëson atyre ta shfrytëzojnë të drejtën e bashkëpronësisë për të aplikuar për grante.<sup>27</sup> Bazuar në analizat tona njëra nga arsytet pse gratë nuk e shfrytëzojnë këtë të drejtë mund të jetë edhe mungesa e informimit të tyre.

### 3.1.2. Mos përfshirja e grave rreth informimit për Programet e Zhvillimit Rural

**Ministria duhet të sigurohet që informatat mbi programin sidomos për mundësinë e përfitimit për masat e programit të ofrohen për publikun e përgjithshëm dhe palët e interesit. Ministria duhet të angazhohet në organizimin e takimeve dhe diskutimeve publike me partneret social dhe ekonomik, popullatën rurale, shoqata të fermerëve dhe palët tjera relevante. Gjithashtu duhet të përkrahë fermerët me trajnime në fushat e specializuara si në bujqësi, çështje ligjore, barazi gjinore dhe zhvillim rural.<sup>28</sup>**

Pas aprovimit të PZHR-së nga ana e Ministrit, dhe shpalljes së thirrjes për aplikim nga AZHB, Autoriteti Menaxhues në bashkëpunim me AZHB mban sesione informuese në shtatë regjionet e Kosovës.

25 Analiza gjinore e projektit, Trajnim profesional dhe mundësi për gjenerimin e të ardhurave në bujqësi për gratë dhe të rinjtë që jetojnë në zonat rurale të Kosovës, Gusht 2020 [https://iadm.org/Uploads/Documents/Pdf/AL/1008/Analiza%20Gjinore\\_Final\(Shqip\).pdf](https://iadm.org/Uploads/Documents/Pdf/AL/1008/Analiza%20Gjinore_Final(Shqip).pdf)

26 Artikull, Jo formaliteti cenon gratë në bujqësi Radio Evropa e lirë 2023 <https://www.evropaelire.org/a/joformaliteti-cenon-grate-ne-bujqesi-/32303973.html>

27 Ligji mbi trashigiminë, Rregulloret e ministrisë, Udhëzimet administrative, PZHR-te

28 MBPZHR, Detyrat dhe përgjegjësit e Departamentit të Politikave të zhvillimit rural (Autoriteti Menaxhues), Departamenti i shërbimeve këshillimore dhe teknike <https://www.mbpzhr-ks.net/sq/departamenti-i-politikave-te-zhvillimit-rural-autoriteti-menaxhues>

Informimi i fermerëve për pjesëmarrje në këto sesione informuese bëhet në koordinimin me drejtorët rajonal të bujqësisë përmes njoftimeve dhe ftesave personale dhe elektronike për fermerë nga rajoni përkatës, shpalljes në media lokale, broshurave, posterave, fletëpalosjeve etj.

Edhe pse Autoriteti Menaxhues në bashkëpunim me AZHB i marrin të gjitha veprimet e nevojshme për informimin e fermerëve për mbajtjen e sesioneve informuese për PZHR, numri i pjesëmarrësve nuk është i kënaqshëm, posaçërisht i grave.

Në tabelën e mëposhtme kemi paraqitur, numrin e pjesëmarrësve në sesionet informuese të ndarë sipas gjinisë.

### Numri i pjesëmarrësve burra/gra në sesionet informuese



Burimi: Autoriteti Menaxhues, Raportet e sesioneve informuese

Nga tabela mund të vërehet se në sesionet informuese të mbajtura në vitin 2019 dhe 2022, numri i grave është dukshëm më i ultë në krahasim me numrin e burrave. Në vitin 2019, rreth 12% e pjesëmarrësve kanë qenë gra, kurse 88% burra. Përderisa, në vitin 2022 rreth 13% e pjesëmarrësve kanë qenë gra dhe 87% burra. Pjesëmarrja e ultë e grave mund të ketë ndodhur si shkak se sesionet informuese mbahen vetëm gjatë periudhës kur bëhet shpallja e thirrjeve për aplikim, e nuk mbahen takime të rregullta me grupet e synuara gjatë tërë vitit. Në vitin 2020-2021, nuk janë mbajtur sesione informuese, promovimi i programit është bërë përmes publikimit të udhëzuesit për fermer në web faqe të Ministrisë. Si mjet i



komunikimit dhe informimit, përveç web faqes është përdorur edhe rrjeti social/facebook, ku janë bërë postime me karakter promovues dhe informues.<sup>29</sup> Ndërsa sa i përket vitit 2023, deri në përfundim të fazës së ekzekutimit të auditimit, entiteti nuk ka zhvilluar sesione informuese. Shpallja e thirrjes për aplikim është bërë në fund të vitit. Përcjellja e informatës tek gratë e zonave rurale do të ndihmonte në rritjen e interesimit të tyre për aplikim dhe kjo do të ndikonte në rritjen e punësimit përmes granteve.

Në mesin e të anketuarve, 34.8% gra janë në dijeni të këshillimeve për bujqësi të ofruara nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR). Nga ana tjetër, 65.3% e të anketuarve nuk janë në dijeni të tyre.

Numri i ultë i pjesëmarrësve gra në sesionet informuese të organizuara nga Autoriteti Menaxhues në bashkëpunim me AZHB-në, ka ndodhur për shkak të mungesës së takimeve, diskutimeve, apo gjetjes së mënyrave tjera më të avancuara për të përçua së informatat tek të gjitha gratë e zonave rurale. Ndërsa, mos mbajtja e sesioneve informuese gjatë periudhës 2020-2021 ka ndodhur për shkak të pandemisë COVID-19.

Mos pjesëmarrja e grave nga zonat rurale në sesionet informuese, mund të ndikoj që shumë gra fermere të mos kenë informata të plota rreth mundësive për përfitim të granteve nga MBPZHR, përmes PZHR-së. Po ashtu, kjo mund të ndikoj që gratë nga zonat rurale të mos arrijnë të përfshihen në tregun e punës.

### 3.1.3. Mangësi në procesin e monitorimit të PZHR-ve

***Divizioni i monitorimit duhet të monitoroj dhe përgatitë raporte mbi zbatimin e politikave/strategjive për zhvillim rural.<sup>30</sup> Komiteti monitorues përmes raporteve të monitorimit të hartuara nga divizioni i monitorimit rishikon progresin në drejtim të arritjes së synimeve, arritjen e outputeve dhe rezultateve të planifikuara, vlerësimin, shqyrton të gjeturat dhe konkluzionet etj.***

Gjatë analizimit të raporteve vjetore të monitorimit të cilësisë së zbatimit të PZHR-ve, kemi vërejtur se raportet përmbajnë analiza të ndryshme të bazuara në treguesit e aktiviteteve, treguesit financiar si dhe treguesit e outputeve (aplikimeve/refuzimeve dhe kontraktiveve). Të gjitha informatat lidhur me rezultatet e matjes së treguesve nëpër raporte, janë paraqitur në vlera totale sipas masave, sektorëve dhe nën sektorëve (nën masave), mirëpo nuk janë të ndara sipas gjinisë edhe pse objektivë strategjike e PZHR-ve është përkrahja e grave ndërmarrëse. Raporti i monitorimit përmban edhe analiza tjera të treguesve të performancës së cilësisë së zbatimit të projekteve të Zhvillimi Rural ku janë paraqitur të dhëna për indikatorin e vendeve të reja të punës, mirëpo as vlerësimi i këtij indikator nuk është i ndarë sipas gjinisë. Raportet e monitorimit janë të rëndësishme, sepse duhet të ofrojnë të dhëna për progresin e arritur në zbatimin e masave në lidhje me arritjen e objektivave të programit.

<sup>29</sup> Raporti i monitorimit të cilësisë së zbatimit të PZHR-së 2020-2021

<sup>30</sup> Rregullore nr.37/2013 për organizimin e brendshëm dhe sistemin e vendeve të punës në ministrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural, neni 11, pika 1.1-2

Arsyeja e mos kryerjes së analizave të tilla sipas gjinisë, ishte mungesa e treguesve në sistemin e monitorimit të Teknologjisë Informative (tutje TI ), përmes të cilëve janë monitoruar dhe analizuar të dhënat për përfituesit e granteve dhe raporteve të marra nga AZHB. Duhet të theksojmë se lidhur me mungesën e indikatorëve të tjerë relevant në sistemin e TI janë identifikuar edhe nëpër raportet e monitorimit. Po ashtu, të gjitha raportet e monitorimit të divizionit monitorues janë vetëm në formë të draftit e jo edhe të aprovuara, në mungesë të Komitetit monitorues si trup mbikëqyrës i monitorimit të PZHR-ve, i cili nuk ka funksionuar që nga viti 2014. Duhet të theksojmë se me miratimin e programit pesë vjeçar të bujqësisë 2023-2027 është hartuar draft rregullorja e punës<sup>31</sup> së Komitetit monitorues e cila është në fazën e shqyrtimit publik.

Në mungesë të analizave të detajuara të treguesve të performancës të ndara sipas gjinisë, raportet e monitorimit nuk ofrojnë informata të duhura për palët e interesit lidhur me arritjen e objektivave sipas qëllimit të masave të PZHR-ve siç theksohet që përparësi do t'i jepet projekteve të realizuara në zonat malore, të propozuara nga gratë ndërmarrëse, fermerët e rinjë dhe projekteve që do të krijojnë vende të reja të punës në zonat rurale. Mos funksionalizimi i komitetit monitorues ka bërë që raportet e monitorimit të PZHR-ve, mos të trajtohen tutje dhe të aprovohen.

## 3.2. Shpallja e thirrjeve për aplikim, shqyrtimi i aplikacioneve dhe procesi i kontrollit të granteve nga Agjencia e Zhvillimit të Bujqësisë

Në këtë kapitull janë paraqitur gjetjet lidhur me vonesat në procesin e shpalljes së thirrjeve për aplikim, mos regjistrimi i aplikuesve sipas gjinisë si dhe procedurat e shqyrtimit të aplikimeve që krijojnë kushte jo të barabarta për gjininë femërore. Rritja e interesimit për fushën e bujqësisë, nuk ka sjellë rritje proporcionale të përfituesve gra. Masat afirmative që janë ndërmarrë nuk kanë arritur të prodhojnë efektin e dëshiruar në përmirësimin e barazisë gjinore. Gjithashtu, ka mangësi në procesin e kontrollit të përfituesve të granteve.

### 3.2.1. Vonesa në shpalljen e thirrjeve për aplikim

***Në mbështetje të realizimit të programit vjetor për zhvillim rural, Agjencia e Zhvillimit të Bujqësisë bën shpalljen e thirrjeve për aplikim për fermerë dhe ekonomi familjare. Programet vjetore për zhvillim rural si dhe shpallja e thirrjeve për aplikim duhet të bëhen në periudhë të duhur kohore.***

Edhe pse një ndër qëllimet kryesore të ndarjes së granteve është: rritja e prodhimit dhe produktivitetit, diversifikimi i aktiviteteve në ferma dhe biznese rurale, krijimi i vendeve të reja të punës, shpalljet

31 Draft Rregullorja e punës për Komitetin Monitorues 2023-2027

e thirrjeve për aplikim për fermerë dhe ekonomi familjare janë bërë me vonesë. Të gjitha thirrjet për aplikim për fermerë dhe ekonomi familjare gjatë periudhës 2019-2022 janë bërë në pjesën e dytë të vitit, ndërsa shpallja për vitin 2023 është bërë në fund të këtij viti<sup>32</sup>, e jo në përputhje me punët sezonale apo në përshtatje me kushtet klimatike.

Thirrja publike për aplikim mbetet e hapur 30 ditë apo në disa raste me vendim të Ministrit edhe 45 ditë.

---

32 Thirrjet për aplikim për fermerë dhe ekonomitë familjare, 2019-2023.

Në tabelën në vijim, është paraqitur koha e hartimit dhe aprovimit të PZHR-ve, hartimit të UA si dhe thirrjeve për aplikim për periudhën 2019-2023.

**Tabela.4. Hartimi dhe aprovimi i PZHR-ve, hartimi i UA dhe thirrjet për aplikim, për periudhën 2019-2023**

Viti	Përcjellja e PZHR për aprovim	Aprovimi i PZHR	UA për zbatimin e PZHR	Shpallja e thirrjeve për aplikim
2019	01.11.2018	23.04.2019	21.05.2019	22.05.-01.07.2019 01.07.-12.07.2019
2020/21	26.02.2020	19.06.2020	17.07.2020	20.07.-20.08.2020 30.01.- 01.03.2021
2022	04.03.2022	10.06.2022	22.06.2022	07.07.-08.08.2022 08.08.-15.08.2022
2023	22.12.2022	30.08.2023	19.10.2023	31.10. - 29.11.2023

Burimi: Të dhënat e marra nga Autoriteti Menaxhues

Nga tabela mund të vërehet se pas hartimit të PZHR-së, procesi i aprovimit të programit zgjat prej 3 deri në 8 muaj. Programi i vitit 2019 është hartuar në kohë, përderisa gjatë periudhës 2020-2023, të gjitha Programet e Zhvillimit Rural janë hartuar dhe sidomos janë aprovuar me vonesë.

Edhe pse në vitin 2023, ka ndryshuar Ligji për Bujqësi ku parashihet se ministri duhet të miratojë programin vjetor jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga miratimi i buxhetit për vitin përkatës, programi vjetor në po të njëjtin vit është aprovuar me tetë (8) muaj vonesë.<sup>33</sup>

Këto vonesa kanë shkaktuar gjithashtu vonesa në shpalljen e thirrjeve për aplikim gjë që ka ndikuar në humbjet e fermerëve në kohë dhe kosto materiale, sidomos kur është fjala për projekte që mund të zhvillohen vetëm në periudha të caktuara kohore brenda vitit.

33 LIGJI NR.08/L-072 PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL, neni 8

### 3.2.2. Procedurat e regjistrimit dhe shqyrtimit të aplikimeve nuk e përkrahin mjaftueshëm gjininë femërore

**AZHB duhet të bëjë regjistrimin e aplikuesve sipas gjinisë. AZHB-ja, gjithashtu duhet të verifikoj respektimin e kriterëve të pranueshmërisë dhe ndikimin e masave afirmative në barazinë gjinore.<sup>34</sup>**

AZHB si autoritet zbatues i programit për zhvillim rural, gjatë regjistrimit të aplikuesve në sistem, bën vetëm një regjistrim të përgjithshëm të tyre. Sa i përket aspektit gjinor, AZHB posedon të dhëna vetëm se sa është numri i përfituesve sipas gjinisë e jo edhe i aplikuesve.

Regjistrimi i të dhënave të ndara sipas gjinisë, është i rëndësishëm që Ministria gjatë hartimit të politikave të ketë një pasqyrë të qartë se sa është interesimi i grave nga zonat rurale për të zhvilluar aktivitetin e tyre nga financimi përmes granteve, që pastaj në bazë të këtyre statistikave të hartoj politikat si dhe të bëjë përcaktimin e kriterëve në baza gjinore.

Në vazhdim të procedurës së shqyrtimit të aplikacioneve të pranuar, AZHB, bën verifikimin e plotësisht të kriterit të pranueshmërisë, që nënkupton kompletimin e dosjes me të gjitha dokumentet e kërkuara, dhe shqyrtimi i saktësisë së planit të biznesit. Kurse më pastaj bën kontrollimin e dokumentacioneve për të verifikuar plotësimin e kriterit të përzgjedhjes.

Gjatë verifikimit të plotësisht të kriterit të pranueshmërisë kemi vërejtur se një numër i konsiderueshëm refuzohen për shkak të mos plotësisht të këtij kriterit. Për ta njohur më afër këtë proces ne kemi bërë testim të mostrave dhe rezultatet e këtij testimi janë paraqitur më poshtë:

**Tabela 5: Procedurat e shqyrtimit të aplikimeve/rastet e refuzuara**

Gjinia	Ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë	Poentimi i kriterëve të përzgjedhjes	Inicimi i procedurave të ankimimit	Përfitues pas procedurave të ankimimit
R1	F	Po	88	Po
R2	F	Jo	/	/
R3	F	Jo	/	/
R4	F	Jo	/	/
R5	F	Po	77	/
R6	F	Po	100	/
R7	F	Jo	/	/

Burimi: Të dhënat nga dosjet e AZHB-së; aplikantët e refuzuar

34 Programi për zhvillim rural 2022, Kontrollët ex-post, fq. 12

Siç vërehet nga të dhënat e paraqitura në tabelën e mësipërme, nga shtatë rastet e refuzuara katër prej tyre janë refuzuar për shkak të kriterëve të pranueshmërisë. Tri nga këto raste janë refuzuar për shkak të përpilimit jo të saktë të planit të biznesit, dhe të njëjtit nuk kanë paraqitur ankesë, kurse vetëm një rast ka inicuar procedura të ankimimit. Kemi vërtetuar po ashtu se njëri nga rastet (rasti i parë i notuar për kriterin e përzgjedhjes) është rikthyer në shqyrtim përmes procedurave të ankimimit dhe pas kësaj ka rezultuar me pranimin si përfitues. Tek rasti ku aplikuesja femër i ka fituar 77 pikë, nuk ka arritur që të jetë përfituese e grantit, për shkak se përfitues janë shpallur ata të cilët janë poentuar me 80 pikë e më lartë. Vlen të ceket se e njëjta aplikuese nuk ka inicuar procedura të ankimimit. Ndërsa tek rasti tjetër ku aplikuesja femër është poentuar me 100 pikë ajo është shpallur përfituese e grantit si dhe ka nënshkruar kontratë me AZHB. Në ndërkohë pasi që ajo nuk e ka realizuar projektin nuk është realizuar asnjë pagesë nga AZHB. Prandaj ky rast ka kaluar në listën e kandidatëve të refuzuar.

Mirëpo, përveç testimit të aplikimeve për plotësim të kriterëve, ne kemi vërtetuar po ashtu se të gjitha aplikacionet e listës së kandidatëve që kalojnë procesin e përzgjedhjes duhet të kalojnë në shqyrtim të dytë. Aplikuesit notohen sipas përmbushjes së kriterëve të përzgjedhjes, pastaj përzgjedhja e përfituesve bëhet nga sistemi elektronik. Pra, sistemi elektronik automatikisht bën radhitjen e kandidatëve sipas pikëve të grumbulluara për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes. Për shembull në rastet kur kanë pikë të barabarta përparësi për të përfituar grantin ka gjithmonë kandidati që ka aplikuar i pari, pa marrë parasysh plotësimin e kriterëve, aq më pak përkatësinë gjinore. Kjo rregull është iniciuar me programin kombëtar të zhvillimit të zonave rurale 2014-2020, kurse vazhdon të praktikohet edhe aktualisht.

Bazuar në të gjitha këto fakte, vijmë në përfundim se procedurat e shqyrtimit të aplikacioneve janë jo favorizuese për barazinë gjinore. Refuzimi i kandidatëve ndodhë për shkaqe teknike; të mos përputhjeve të shumave të planit të biznesit apo mos plotësimin të formularëve si duhet, e që ka raste kur përmes procesit të ankimimit vërtetohet se refuzimi ka qenë i paarsyeshëm. Ndërsa në rastet kur kandidatet gra i plotësojnë kriteret e përzgjedhjes por kanë pikë të barabarta me kandidatët e tjerë, përsëri i nënshtrohen rrezikut që të refuzohen për shkak të seleksionimit të bërë nga sistemi elektronik i bazuar në kohën kur aplikuesit kanë postuar aplikacionin.

AZHB-ja nuk i shqyrton të gjitha rastet e ankesave me arsyetimin se nuk janë plotësuar dokumentet dhe plani i biznesit ka qenë jo i saktë. Në anën tjetër sistemi elektronik bënë një selektim automatik të aplikuesve në bazë të kohës kur mbërrin aplikimi, pa konsideruar përparësinë gjinore.

Një analizë krahasuese e përfituesve gra/ burra është paraqitur në tabelën në vijim:

**Tabela 6: Te dhënat krahasuese, raporti gra/ burra përfitues për nën sektorët e masës 1; Investimet ne pasuritë fizike të ekonomive bujqësore:**

Viti i aplikimit	Depo		Serra		Grumbullimi i qumeshtit		Perpunimi i qumeshti i lopes		Perpunimi i qumeshtit dele dhe dhi		Rritja e derrave		Rritja e gjedhave		Kultivimi i shpezeve		Vresht-aria		Pemët dru-frutore		Pemët manore		Pemët arrore	
	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M
2019	6	7	55	35	0	3	8	24	0	10	2	5	12	33	2	5	4	8	24	43	/	/	/	/
2020/21	/	/	43	63	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	15	44	/	/	7	17
2022	12	21	2	7	0	2	4	27	0	6	0	4	4	35	3	12	5	13	14	38	3	14	9	20
Total	18	28	100	105	0	5	12	51	0	16	2	9	16	68	5	17	9	21	53	125	3	14	16	37

Burimi: Të dhënat nga Agjencia e Zhvillimit Rural, Listat e sektorëve te Masës 1 për vitet 2019-2022

Sipas të dhënave të paraqitura në tabelë vërehet se gratë përfituese janë dukshëm në numër më të ulët në krahasim me burrat në njëmbëdhjetë sektorët e bujqësisë në kuadër të masës 1 “Investimet në asetet fizike dhe ekonomitë familjare”.

Në bazë të anketës së zhvilluar sa i përket aplikimit, nga numri i përgjithshëm prej 400 grave, 12% e të anketuarave (ose familjarëve të tyre) kanë aplikuar për këto grante, ndërsa shumica, (88%) jo. Të anketuarat që aplikuan për grante, arsyet për refuzimin e grantit ndryshojnë. Një pjesë e konsiderueshme (30.6%) raportuan se nuk u ishte dhënë një arsye specifike për refuzimin. Rreth 22.2% treguan se toka nuk ishte e regjistruar në emër të tyre apo të familjes së tyre, ndërsa 33.3% përmendën mosplotësimin e kriterëve, siç janë mungesa e tokës, dokumentacionit apo burimeve ujore. Një përqindje më e vogël, 5.6%, shprehin besimin se grantet nuk janë shpërndarë në mënyrë të drejtë. Për më tepër, 8.3% cituan arsye të tjera për refuzimin.

Sfidat në aplikimet për grante përfshijnë refuzime të paqarta (pa dhënien e arsyes) (30.6%), tokë të paregjistruar (22.2%) dhe mosplotësim të kriterëve (33.3 %).


Si pasojë e refuzimit të aplikuesëve, gratë përfituese janë dukshëm në numër më të ulët në krahasim me burrat në njëmbëdhjetë sektorët e bujqësisë në kuadër të masës 1 “Investimet në asetet fizike dhe ekonomitë familjare”. Ky raport jo i barabartë është i dukshëm sidomos në sektorin e serrave dhe drufrutoreve si veprimtari ku gratë kanë shprehur më shumë interes. Për shkak të kësaj nuk është arritur përmbushja e objektivës për zbutjen e papunësisë së grave në nivel të mundshëm dhe në zonat ku këto veprimtari kanë pasur mundësi të zhvillohen.

### 3.2.3. Rritja e interesimit për disa nga sektorët e bujqësisë nuk e ka rritur edhe numrin e grave përfituese

**AZHB-ja duhet të verifikoj respektimin e kriterëve të pranueshmërisë dhe ndikimin e masave afirmative në barazinë gjinore. Një nga objektivat e PZHR-së është përmirësimi i cilësisë së jetës, zhvillimi i komunitetit dhe përfshirja sociale në zonat rurale.<sup>35</sup>**

Kemi vërejtur se gjatë periudhës audituese numri i të interesuarave që i përkasin gjinisë femërore për grantet e masës “Investimet në pasuritë fizike në ekonomitë bujqësore”, ka qenë vazhdimisht në rritje. Këtë na e dëshmon pasqyra e të dhënave të paraqitura më poshtë ku shihet një rritje proporcionale nga viti në vit.

**Diagrami 1: Trendi zhvillimorë i aplikuesve gra për masën: “Investimet në pasuritë fizike në ekonomitë bujqësore”, periudha 2019-2022**




Siç shihet në diagram, trendi i rritjes së interesimit në vitin 2020/21 ka qenë relativisht më i lartë se në vitin paraprak 2019, edhe pse për shkak të pandemisë nuk janë financuar të gjithë sektorët e kësaj mase.<sup>36</sup> Kurse në vitin 2022 ky nivel pothuajse është dyfishuar në krahasim me vitin 2019.

Po ashtu është vërejtur se përkundër rritjes së numrit të aplikueseve, niveli i përfituesve nga gjinia femërore ka pësuar rënie, ashtu siç mund të shihet në analizën krahasuese mes raportit aplikues/përfitues.

<sup>35</sup> Programi për zhvillim rural 2022., objektivat kryesore të PZHR-së

<sup>36</sup> Sektorët e financuar në vitin 2020/21 janë serrat, manore dhe drufrutore



**Grafiku 2: Raporti mes aplikuesve /përfituesve të gjinisë femërore 2019-2022**

Të dhënat: Listat e aplikuesve 2020-2023, AZHB

Siç shihet nga diagrami, niveli i lartë i aplikuesve gra qëndron në raport të zhdrejtë me nivelin e përfitueseve. Kjo na jep të kuptojmë se sa i përket investimeve në asetet fizike, procedurat e zbatuara të përzgjedhjes nuk kanë arritur të avancojnë përfshirjen dhe angazhimin e grave në këta sektorë. Vlen të ceket se për shkak të periudhës së pandemisë, gjatë viteve 2020/21 rënia e përfituesve në krahasim me aplikueset është edhe më i lartë. Në këtë periudhë thirrja është hapur vetëm për tre sektorë; drufrutore, serra dhe manore. Mirëpo numri i përfituesve nga gjinia femërore ka vazhduar të jetë i ulët në krahasim me numrin e aplikueseve edhe në vitin pasues. Kjo tregon se refuzimi i tyre ka qenë nga 76-87% të numrit total të aplikueseve të gjinisë femërore.

Shkaktar i këtij zhvillimi jo proporcional mes aplikueseve dhe përfituesve kanë qenë kushtëzime, me pronësinë, moshën e fermerit dhe masat e tjera të ndërmarra në kritere menjëherë pas vitit 2019. Për një periudhë të caktuar kohore mund të themi se këtë dukuri e ka ndikuar pandemia për shkak të së

cilës sektorët e kësaj mase janë reduktuar në vetëm tre. Mirëpo kjo dukuri ka vazhduar të shfaqet edhe në vitin pasues 2022, gjatë të cilit vit janë ashpërsuar kushtëzimet dhe kanë ndryshuar disa kritere<sup>37</sup>.

Sipas autoriteteve këto vendime janë ndërmarrë për parandalimin e krijimit të kushteve artificiale, në kuptimin e evitimit të kandidatëve që aplikojnë vetëm për të përfituar pikët afirmative dhe nuk angazhohen në menaxhim të projekteve. Mirëpo, kjo gjë nuk ka mundur të dëshmohet nga AZHB me raporte që e dokumentojnë krijimin e këtyre kushteve apo që projektet nuk menaxhohen nga përfitueset gra.

Si pasojë e kësaj, janë anashkaluar një numër i madh i të interesuarave gra, të cilat kanë shprehur interesim për sektor të caktuar si përpunimin e pemëve dhe perimeve. Vlen të ceket se edhe për autoritetet është e njohur se gratë i shohin si mundësi të mirë sektorët ku hyjnë serrat dhe drufrutoret, për përfshirjen e tyre në tregun e punës.

### 3.2.4. Kushtëzimi i masave afirmative bënë të pa efektshëm qëllimin e tyre

**AZHB-ja duhet të verifikoj respektimin e kritereve të pranueshmërisë dhe ndikimin e masave afirmative në barazinë gjinore.<sup>38</sup>**

Sipas programit për zhvillim rural 2014-2020, kriteret e përzgjedhjes janë të përcaktuara me pikët minimale dhe maksimale sipas analizave paraprake.<sup>39</sup> Kriteri i përkatësisë gjinore gjegjësisht pikët afirmative<sup>40</sup> për këtë qëllim kanë filluar të aplikohen nga viti 2014 si masë socio ekonomike për plotësimin e parimit të gjithë përfshirjes dhe barazisë gjinore.

Këto pikë afirmative, kanë vazhduar të aplikohen si standarde afirmative edhe gjatë periudhës audituese 2019-23.

Mirëpo, në ndërkohë ka pasur ndryshime në aspektin e parimeve të reja kushtëzuese me tre deri në pesë vite si pronare e tokës apo e biznesit si dhe moshën e fermerit të cilat sipas autoriteteve janë ndërmarrë për shkak të krijimit të kushteve artificiale.<sup>41</sup> Siç theksojnë autoritetet, shumica e projekteve në emër të grave janë menaxhuar nga burrat, mirëpo, ne kemi konstatuar se të dhënat e ofruara rreth përfituesve të granteve nuk japin një pasqyrë krahasuese se nga kush dhe si menaxhohen këto projekte.

37 Më konkretisht, për nën-sektorët "Ngritja e serrave", dhe " Pemëtaria; drufrutore / manore" ka pasur ndryshime në kritere si; gjatë viteve 2019-2023, ka hyrë kriteri i ri " Aplikues i ri", (nën moshën 40 vjeçe) dhe " Investimet në zonat malore".

38 Programi për zhvillim rural 2022, Kontrolllet ex-post, fq. 12

39 Programi për bujqësi dhe zhvillimit rural 2014-2020

40 Politika favorizues/masa afirmative për gratë, me qëllim të fuqizimit të grave në bizneset bujqësore – rurale.

41 Krijimi i Kushteve artificiale për të marrë pikë paraqet mashtrim dhe do të ndëshkohet sipas nenit 38A, nen-nen-paragrafit, 1.2.3 të Ligjit Nr.04/L-090 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.03/L098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin rural. (PBZHR 2020/21 Fq 35)

Analizat e mostrave të auditimit tregojnë për një efekt të dobët të masave afirmative, ka pasur raste kur kjo masë nuk është zbatuar fare. Më poshtë kemi pasqyruar zbatimin e masës afirmative në shtatë raste të ekzaminimit të dosjeve të përfituesve:

**Tabela 7: Zbatimi i masave afirmative dhe ndikimi i tyre:**

Viti	Gjinia	Projekti	Poentimi	Piket afirmative
Masa: Investimet në asetet fizike				
2019	F	Ngritja e pemishtes	88	2
2020	F	Ngritja e pemishtes	92	2
2021	F	Ngritja e pemishtes	88	0
2022	F	Ngritja e serres	83	0
Masa: Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve				
2020/21	F	Shtimi i kapacitetit të mjaltit natyral dhe mbarshtimi i bletëve	82	2
2020/21	F	Ndërtimi i dhomës së mjaltit dhe investimet në koshere	87	2
2022	F	Zhvillimi dhe promovimi i turizmit rural dhe agroturizmit, ndërtimi i 3 villave të drurit	75	0


Siç mund të vërehet, pikët afirmative janë zbatuar vetëm në katër raste nga shtatë aplikante gra, ndërsa në tri raste tjera nuk janë aplikuar, për shkak të mos arritjes së plotësimit të kriteve.

Tek masa 302/7 “Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve”, e cila konsiderohet si masë afirmative për përkrahjen e gjinisë femërore me grante investive, gjatë periudhës 2019-2021 aplikueset gra nga kjo masë janë poentuar me 2 pikë shtesë, ndërsa në vitin 2022 numri i pikëve shtesë për gra është rritur nga 5 -10 pikë, varësisht nga sektorët/nën masat. Mirëpo, në vitin 2022, numri i grave aplikuese/përfituese ka shënuar rënie në krahasim me vitet paraprake, dhe është në nivel më të ultë në raport me numrin e aplikuesve/përfituesve të gjinisë mashkullore.

Në grafikun e mëposhtëm është paraqitur numri i përfitueseve gra dhe burra, për Masën “Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve”, gjatë periudhës 2019-2022.

### Grafiku 3. Numri i aplikuesve dhe përfituesve sipas gjinisë, për periudhën 2019-2022

#### Numri i aplikuesve dhe përfituesve sipas gjinisë, masa 302: Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve, për periudhën 2019-2022



Burimi: AZHB, 2019-2022

Nga grafikoni mund të vërejmë se gjatë vitit 2019, 54.4% e përfituesve kanë qenë gra, kurse 45.6% burra. Në vitin 2020/21 numri i përfituesve gra ka shënuar një rënie të lehtë, kurse është rritur numri i përfituesve burra dhe ka arritur shkallën 50:50. Përderisa, në vitin 2022 numri i përfituesve gra ka vazhduar të shënoj rënie duke arritur në 44.3%, kurse burrat duke shënuar ngritje dhe arritur në 55.7%.

Pikët afirmative nuk zbatohen për të gjitha rastet e aplikimit, për shkak të kriterit të pronësisë, siç është theksuar edhe më lartë se gratë i marrin pikët afirmative vetëm nëse janë pronare të tokës apo bizneseve 3 vitet e fundit.

Në lidhje me pikët shtesë për gratë aplikante dhe/ose pronare biznesi në kontekstin e aplikimeve për grante për bujqësi, rezultatet e anketës zbuluan se 26.5% e të anketuarve ishin në dijeni të kësaj politike, duke pranuar se gratë marrin pikë shtesë gjatë procesit të vlerësimit. Në anën tjetër, 73.5% e të anketuarave nuk ishin në dijeni të kësaj politike.

Të dhënat mbi pronësinë e tokës, konkretisht nëse e anketuara apo ndonjë grua në familje është pronare apo bashkëpronare e tokës, tregojnë se 4.8% e të anketuarave pohojnë pronësinë apo bashkëpronësinë.

Anasjelltas, shumica, 72.8%, raportojnë se nuk janë pronare apo bashkëpronare as vetë as ndonjë grua në familje.

Megenëse problemet e pronësisë janë dukshëm më të shprehura te gjinia femërore, mos zbatimi i masës afirmative për të gjitha rastet rrit numrin e të refuzuarave nga gjinia femërore. Kushtëzimi me pronësinë ka pasur ndikim të dyfishtë në pikët afirmative duke i humbur më tepër se 10 pikë gjatë vlerësimit të kriterëve të përzgjedhjes dhe zvogëluar gjasat që ato të jenë përfituese. Grave nuk ju është ofruar një mundësi më e lehtë e ushtrimit të kësaj veprimtarie e cila edhe pse është e lidhur me patundshmëri është dëshmuar se mund të udhëhiqet suksesshëm nga gjinia femërore.

### 3.2.5. Mangësi në procesin e kontrolleve të përfituesve të granteve

***Drejtoria e kontrollës pranë AZHB-së duhet të bëjë planifikimin, organizimin dhe kryerjen e kontrolleve në terren të përfituesve të granteve për super kontrollë dhe Ex-post kontrollë.<sup>42</sup> Kontrollat në terren duhet të kryhen nga një ekip prej dy inspektorësh të cilët duhet të jenë në rotacion.<sup>43</sup> Kontrolli i dytë realizohet pas kryerjes së investimeve sipas kontratës dhe paraqitjes së pakos së kërkesës për pagesë nga përfituesi dhe në rast të mospërputhjes me planin investiv ndikon në miratim për pagesë. Kërkesa për pagesë do të refuzohet për projekte të cilat nuk kanë finalizuar ndonjë aktivitet për të cilin është poentuar gjatë procesit të vlerësimit<sup>44</sup>.***

Gjatë analizimit të mostrave të përfituesve të granteve të masës 101 “Investimet në asetet fizike të ekonomive bujqësore” dhe 302/7 “Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i biznesit” për vitet 2019-2022 kemi vërejtur se gjithë përfituesit kanë kaluar në kontrollin e parë dhe të dytë siç kërkohet me procedura. Tutje, gjatë analizimit të tyre të pjesa e raporteve të kontrolleve kemi vërejtur se procesi i kontrollës (kontrollës së dytë dhe ex post kontrolla) ishte kryer dy herë radhazi nga i njëjti inspektor tek i njëjti përfituesi i PZHR-së për vitin 2019. Kontrolla ex post ishte kryer ende pa u bërë tri vite pas aprovimit të pagesës përfundimtare të përfituesit.<sup>45</sup>

Më tutje, në një rast tjetër gjatë verifikimit kemi vërejtur se pagesa për përfituesin e nën masës 101.1 ishte miratuar megjithëse nuk ka pasur dëshmi që ka siguruar krijimin e vendeve të reja të punës. Kontrolla e dytë lidhur me përfituesin e caktuar ishte kryer, megjithatë nuk ka evidentuar mos plotësimin e kriterit për sigurimin e vendeve të reja të punës. Duhet të theksohet se te i njëjti përfitues ishte kryer ex-post kontrolla dhe në raport ishte identifikuar që përfituesi nuk e posedon listën e të punësuarve për të cilën ka fituar si dhe nuk posedon librin e kontabilitetit.

42 Rregullore e kontrollës, Udhëzim për kryerjen e kontrolleve në terren, qershor 2010, ripërpunuar 2020, neni 3, faqe 5

43 Udhëzim për kryerjen e kontrolleve në terren, qershor 2010, ripërpunuar 2020, neni 11, faqe 6

44 UA për masat dhe kriteret e përkrahjes për zhvillimin rural për vitin 2019, kapitulli II, masa 101 Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore, neni 6, pika 9.

45 Duhet theksohet se te i njëjti përfitues me kërkesë të policisë së krimeve ekonomike është kryer edhe superkontrollë

Për të parë, se si përfituesit e granteve i kanë realizuar projektet e tyre, kemi bërë vëzhgimin fizik të tyre edhe në terren, ku kemi vizituar 6 përfitues të granteve, 4 përfituese gra dhe 2 përfitues burra. Rezultatet e observimit fizik janë të shpalosura më poshtë.

**Projekti: Investimet në ngritjen e pemishtes me lajthia me sistem të ujitjes dhe mekanizëm bujqësorë**



**Foto 1: Observimi fizik në terren, Dashec Podujevë (Gjinia e përfituesit, femër)**

Në këtë projekt janë mbjellur 3000-5000 fidane të lajthisë. Investimet në mjetet si, sistemi i ujitjes, panelet solare dhe një traktori bujqësor janë realizuar. Sipas fermeres, si biznes familjarë projekti ka angazhuar anëtarët e familjes, kurse gjatë sezonës së verës ka angazhuar punëtorë sezonal. Po ashtu, kanë theksuar se koha nuk ka qenë në favor të rritjes së bimëve sepse ka pasur dëmtime nga reshjet. Projekti ka kaluar fazën fillestare.

**Projekti: Ngritja e pemishtës së lajthisë, investim në makineri për pemishte**



**Foto 2. Observimi fizik, Babimoc, Obiliq (Gjinia e përfituesit, femër)**

Në këtë projekt janë mbjellur 330 drunjë-pemë dru frutore. Toka e ka të instaluar sistemin e ujitjes dhe panelet solare. Progresi i fidaneve - arra dhe lajthi është i dobët. Sipas të autorizuarit, projekti ka ngecur sepse nuk ka pasur kushte të mira atmosferike dhe reshjet e shumta i kanë dëmtuar të mbjellat. Projekti është ende në fazën fillestare.



### **Projekti: Investimet në ndërtimin e serrës**



**Foto 3. Observimi fizik, Podujevë (Gjinia e përfituesit, mashkull)**

Në këtë projekt, një pjesë e serrës është ndërtuar dhe është bërë instalimi i pajisjeve. Gjithashtu, produktet e serrës janë nxjerr në treg. Sipas përfituesit nuk ka qenë e mundur të mbillet tërë sipërfaqja e paraparë për shkak të verifikimit kadastral të tokës. Andaj, për shkak se serra nuk është mbjellë në tërësi me perime, mund të konsiderohet se projekti është ende në fazën fillestare.

### **Projekti: Shtimi i kapacitetit të mjaltit natyral dhe mbarshtimi i bletëve**



**Foto 4: Observimi fizik, Lubishtë, Viti (Gjinia e përfituesit, femër)**

Në këtë projekt përfituesja ka arritur të bëjë 100 koshere të bletëve, të cilat i ka vendosur në 3 lokacione, është biznes familjar. Ky projekt është realizuar me sukses dhe ka arritur të ketë produktivitet. Projekti vlerësohet si i përfunduar.

### **Projekti: Ndërtimi i dhomës së mjaltit dhe investimet në koshere**



**Foto 5. Observimi fizik Hajkobillë, Prishtinë  
(Gjinia e përfituesit, femër)**

Në këtë projekt është bërë ndërtimi i dhomës së mjaltit dhe paisjet tjera për koshere, përfshirë edhe instalimin e paneleve solare. Sipas familjarit të autorizuar nuk ka qenë sezona e përshtatshme për të zhvilluar veprimtarinë. Projekti është realizuar pjesërisht.

### **Projekti: Ndërtimi i bujtinave**



**Foto 6: Observimi fizik Veskoc, Vushtrri (Gjinia e përfituesit, mashkull)**

Në këtë projekt janë ndërtuar 3 bujtina si dhe janë instaluar panelet solare. Projekti është në fazën përfundimtare, mirëpo nuk ka filluar të përdoret sipas qëllimit për zhvillimin e turizmit rural, për shkak se deri në kohën kur është realizuar vëzhgimi në terren nuk është shfaqur interesim për ti shfrytëzuar këto bujtina.

Nga vëzhgimi i projekteve kemi vlerësuar se dy nga to janë në fazën fillestare të implementimit, tri janë realizuar pjesërisht dhe vetëm një nga gjashtë projektet e vëzhguara është realizuar plotësisht. Realizimi i projekteve përveç që ndikohet nga rrethanat klimatike, poashtu mund të ndikohet nga menaxhimi administrativ, shpallja e thirrjes për aplikim si dhe mbikëqyrjes së vazhdueshme për realizim efektiv.

Mangesitë në procesin e kontrolleve nga AZHB janë; në bazë të informatave dhe sipas zyrtarëve përgjegjës, caktimi i të njëjtit inspektor tek përfituesi i njëjtë në dy faza të kontrollës radhazi, kjo ka ndodhur për arsye se nuk kanë pasur alternativë tjetër në caktimin e inspektorëve të ndryshëm. Kjo për shkak të angazhimit të tyre në kryerjen e numrit të madh të kontrolleve, si dhe mundësisë së lëshimeve teknike nga vëllimi i madh i punës. Kryerja e kontrolleve të njëpasnjëshme tek përfituesi i njëjtë nga i njëjti inspektor nuk është në përputhje me procedurat e brendshme të kontrollës dhe është konflikt i interesit pasi që mund ti mundësoj inspektorit të ketë ndikim te përfituesi i grantit.



Ndërsa arsyen e ekzekutimit të pagesës pa plotësimin e kriterit për të cilin edhe është poentuar nuk kemi arritur ta kuptojmë edhe pse kemi kërkuar dëshmi. Pasojë e kësaj është se nuk mund të konfirmohet numri i të punësuarve apo hapja e vendeve të reja të punës të parapara në projekt.

### 3.3. Regjistrimi i punëkërkueseve dhe profilet e aftësimin për gratë e zonave rurale nga Agjencia e Punësimit

Në këtë kapitull është paraqitur gjetja për Agjencinë e punësimit lidhur me mungesën e të dhënave sipas gjinisë në zona urbane dhe rurale. Gjithashtu janë paraqitur shërbimet e aftësimin dhe profilet që janë në mungesë për aftësimin e grave në zonat rurale.

#### 3.3.1. Mungojnë të dhënat dhe shërbimet e aftësimin profesional të ndara sipas zonave urbane dhe rurale

**Agjencia e Punësimit duhet të hartoj plane individuale të punësimit për grupet e cenushme, përmes ofrimit të trajnimeve në punë, subvencionimit të punësimit, vetëpunësimit dhe promovimit të ndërmarrësisë. Gjithashtu duhet të përgatisë informacione, analiza, hulumtime, dhe studime për nevojat e tregut të punës.<sup>46</sup>**

Agjencioni i Punësimit (tutje APRK) posedon një sistem të gjenerimit të të dhënave. Të gjitha shërbimet e ofruara nga ana e APRK-së, janë të klasifikuara sipas: gjinisë, etniteteve, rajoneve, grup-moshave, kualifikimeve, profesioneve, veprimtarive ekonomike dhe sektorit pronësor.

Në tabelën në vijim është paraqitur numri i punëkërkuësve sipas gjinisë, për periudhën 2019-2022.

**Tabela 8. Regjistrimi i punëkërkuësve sipas gjinisë, për periudhën 2019-2022**

Viti	2019	2020	2021	2022
Gra	32,382	75,701	38,568	39,169
Burra	38,408	93,279	43,474	41,606
Gjithsej	70,790	168,980	82,042	80,775

Burimi: Raportet vjetore të Performancës 2019-2022, "Puna dhe Punësimi", APRK

46 Ligji NR. 04/L-205 Për Agjencinë e Punësimit të Republikë së Kosovës, neni 6 pika 1.1 dhe 1.2

Siç mund të vërehet nga tabela, çdo vit numri i grave punëkërkuese është më i ultë në krahasim me numrin e burrave. Po ashtu mund të vërehet se numri i punëkërkueseve dallon nga viti në vit. Përqindja e punëkërkueseve të regjistruar në vitin 2022 krahasuar me vitin 2021 tek burrat ka pësuar një rënie prej 4.3%, ndërsa tek gratë është shënuar rritje prej 1.6%.

Nga numri i përgjithshëm i punëkërkueseve të regjistruar, pjesën më të madhe e zënë personat e pakualifikuar dhe ata me nivel të ulët arsimimi, përkatësisht personat me shkollë të ulët dhe të mesme. Këto kategori përbëjnë 90.3% të numrit të punëkërkueseve të regjistruar.

Numrin e ndërmjetësimeve të rregullta në punësim, të bëra nga ana e APRK-së janë paraqitur në tabelën në vijim.

**Tabela 9. Ndërmjetësime të rregullta në punësim sipas gjinisë, për periudhën 2019-2022**

Viti	2019	2020	2021	2022
Gra	1,794	574	1,499	2,147
Burra	2,366	756	1,456	2,313
Gjithsej	4,160	1,330	2,955	4,460

Burimi: Raportet vjetore të Performancës 2019-2022, "Puna dhe Punësimi", APRK

Nga të dhënat e paraqitura në tabelë mund të vërehet se vetëm në vitin 2021, gratë kanë përfituar një përqindje pak më të lartë në krahasim me burrat, nga procesi i ndërmjetësimit të rregullt në punësim, ku gratë kanë përfituar rreth 51%, kurse burrat rreth 49%. Ndërsa në tri vitet e tjera, përqindja e burrave përfitues ka qenë më e madhe në krahasim me numrin e grave

Ndërsa numri i ndërmjetësimeve në punësim përmes masave aktive të tregut të punës është paraqitur në tabelën në vijim.

**Tabela 10. Ndërmjetësimet në punësim përmes masave aktive të tregut të punës sipas gjinisë, për periudhën 2019-2022**

Viti	2019	2020	2021	2022
Gra	2,198	2,915	2,065	1,249
Burra	2,413	2,716	1,232	763
Gjithsej	4,611	5,631	3,297	2,012

Burimi: Raportet vjetore të Performancës 2019-2022, "Puna dhe Punësimi", APRK

Të dhënat e paraqitura në tabelë, tregojnë se nga ndërmjetësimet në punësim përmes masave aktive të tregut të punës vetëm në vitin 2019, gratë kanë përfituar rreth 48% që është përqindje më e ultë në krahasim me burrat të cilët kanë përfituar rreth 52%. Ndërsa gjatë periudhës 2020-2022, përqindja e grave përfituese është më e lartë në krahasim me burrat. Përqindja e grave përfituese sillet rreth 52-63%, kurse e burrave rreth 37-48%.

Mirëpo, ne kemi vërtetuar se APRK nuk posedon të dhëna specifike për zonat urbane dhe rurale; që tregojnë se sa është numri i punëkërkuësve, ndërmjetësimeve apo shërbimeve tjera.

Mungesa e të dhënave të ndara sipas zonave urbane dhe rurale ka ndodhur për shkak se Agjencia e Punësimit nuk e përcakton këtë indikator matës rreth punësimit të grave nga zonat rurale dhe për pasojë nuk ka një pasqyrë të qartë për gjendjen dhe nevojat e grave nga zonat rurale. Duke marrë parasysh se shkathtësitë profesionale luajnë një rol shumë të rëndësishëm në gjetjen e një vendi pune<sup>47</sup> ne kemi analizuar të gjithë sektorët ku ofrohen këto shërbime.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur numri i përfituesve nga aftësimet profesionale të ndara sipas gjinisë.

**Tabela 11. Aftësimet e përgjithshme profesionale sipas gjinisë, për periudhën 2019-2022**

Viti	2019	2020	2021	2022
Gra	2,264	901	932	990
Burra	4,339	2,535	2,221	1,807
Gjithsej	6,603	3,436	3,153	2,797

Burimi: Raportet vjetore të Performancës 2019-2022, "Puna dhe Punësimi", APRK

Të dhënat e paraqitura në tabelë tregojnë se numri i pjesëmarrjes së grave në aftësime profesionale është dukshëm më i ulët se sa pjesëmarrja e burrave.

Në kuadër të këtyre shërbimeve Agjencia e punësimit nuk ofron shërbime të aftësimeve profesionale për shumicën e sektorëve të bujqësisë. Vlen të ceket se në vitin 2022 janë ofruar vetëm dy lloje të aftësimit profesional që mbulojnë sektorët e përpunimit të qumështit dhe pemëve e perimeve.<sup>48</sup>

Në bazë të anketës të dhënat për statusin e regjistrimit në Zyrën e Punësimit tregojnë se 19% e të anketuarave janë aktualisht të regjistruara, ndërsa shumica (81%) nuk janë të regjistruara.

Të dhënat tregojnë se 15.5% e të anketuarave janë të informuar për mundësitë e trajnimit profesional që ofron Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës (APRK), dhe 11.3% kanë marrë pjesë në këto trajnime. Në anën tjetër, 84.5% e të anketuarave nuk janë të informuara për mundësitë e tilla të trajnimit, dhe 88.7% nuk kanë marrë pjesë në asnjë trajnim profesional të organizuar nga APRK-ja.

Mungesa e aftësimit profesional për gratë në zonat rurale në shumicën e sektorëve të bujqësisë si dhe mungesa e informatave të ndara sipas zonave urbane dhe rurale, ka efekt negativ dhe me ndikim në integrimin e tyre në tregun e punës.

47 Punesimi dhe aftesimi profesional

48 Raportet vjetore të Performancës 2019-2022, "Puna dhe Punësimi", APRK



---

**KONKLUSIONEN**

**04**

## 4. Konkluzionet

Institucionet përgjegjëse publike kanë ndërmarrë një sërë veprimesh për fuqizimin e pozitës së gruas në shoqëri, mirëpo ende nuk janë arritur rezultate të kënaqshme për përfshirjen e grave nga zonat rurale në tregun e punës. Programet e Zhvillimit Rural dhe masat afirmative nuk kanë arritur të sigurojnë një përkrahje të barabartë për të dy gjinitë dhe nuk ka një vlerësim rreth arritjes së qëllimeve të programit nga perspektiva gjinore. Masat afirmative kushtëzojnë gratë me tre deri në pesë vite si pronare e tokës apo e biznesit, duke e bërë të pa efektshëm qëllimin e tyre, për shkak se kufizon pjesëmarrjen apo përkrahjen e grave dhe vajzave të cilat kanë filluar aktivitetin e tyre rishtazi. Mungon një aktivizim më i madh në informimin e duhur të grave për shfrytëzimin e të drejtës së tyre të garantuar me ligj. Përderisa, mungesa e funksionalizimit të Komitetit Monitorues, ka shkaktuar probleme në procesin e monitorimit të programeve për Zhvillim Rural dhe si rrjedhojë nuk kanë të dhëna për të pasqyruar rezultatet e arritura apo ndikimin e tyre në përfshirjen e grave nga zonat rurale në tregun e punës, arritjen e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave.

Agjencia e Punësimit nuk posedon të dhëna të ndara sipas gjinisë për zonat urbane dhe rurale në lidhje me regjistrimin, shërbimet e punësimit, pjesëmarrjen në masat aktive të tregut të punës dhe aftësimin profesional të të papunëve të regjistruar. Në veçanti, mungesa e shërbimeve për aftësimin profesional të grave fermere bën që kjo kategori të ketë vështirësi në përfshirjen e tyre në tregun e punës.

Programet dhe masat e MBPZHR-së nuk sigurojnë përkrahjen e barazisë gjinore. Ndryshimi i kriterëve dhe poentimi i tyre është bërë pa ndonjë analizë duke e ndikuar masën afirmative dhe parimin e gjithë përfshirjes. Në mungesë të pronës kandidatet kanë humbur pikët për të dy kriteret dhe ky efekt i dyfishuar tregon një implikim negativ mes tyre. Ministria nuk ka paraparë një skemë zhvillimore progresive për të përfshirë në vazhdimësi gratë e interesuara në bujqësi duke rritur dhe pasuruar skemën e masave afirmative. Vlen të ceket se observimi fizik i kryer nga ekipi i auditimit ka treguar se progresi i projekteve ka pasur dobësi si tek përfituesit burra po ashtu edhe te ato gra.

Autoriteti Menaxhues bashkëpunon me AZHB-në për të organizuar sesione informuese mbi PZHR-në dhe publikon materiale informuese në faqen e internetit të Ministrisë, si udhëzime për plotësimin e formularëve dhe informacione të tjera për aplikuesit. Por, ende ka mangësi në përcjelljen e informatës të gratë që jetojnë në zonat rurale.

Vonesat në hartimin dhe aprovimin e Programeve për Zhvillim Rural kanë shkaktuar vonesa të tjera zingjyrore si në shpalljen e thirrjeve për aplikim po ashtu edhe në përzgjedhjen e përfituesve të granteve.

AZHB nuk disponon informacion të plotë mbi numrin e aplikuesve në baza gjinore për përfitimin e granteve. Kjo mungesë e informacionit mund të krijojë pengesa gjatë hartimit të politikave që synojnë të mbështesin zhvillimin e përgjithshëm, me fokus të veçantë në përmirësimin e statusit të grave në zonat rurale.

Aplikuesit për grante i nënshtrohen procedurave të verifikimit administrativ dhe përmbajtësorë të dokumentacionit. Për shkak të procedurave të komplikuar dhe shpesh të paarritshme për gratë fermere me nivel të ulët arsimor, si dhe sistemit elektronik të përdorur për seleksionimin e përfituesve, pamundësohet përzgjedhja e e përfituesve të granteve sipas një gjykimi objektiv duke u bazuar në parimin e barazisë gjinore.

Ekziston një rritje e interesimit gjatë viteve 2019-2022 për grantet e ofruara për masën<sup>1</sup>, "Investimet në asetet fizike dhe ekonomive familjare" mirëpo në krahasim me numrin total të të gjithë aplikanteve, 76-87% të tyre janë refuzuar, dhe përfitues nga gjinia femërore janë në numër të ulët prej 13-24%. Refuzimi i aplikanteve gra ka ndodhur për shkak të procedurave të komplikuar gjatë shqyrtimit dhe verifikimit për përmbushjen e kriterëve të pranueshmërisë apo edhe atyre të përzgjedhjes.

Ministria nuk ka arritur që të kryej vlerësime ex-post të PZHR-ve, përmes të cilave do të vlerësohej ndikimi i investimeve të bëra përmes granteve. Mungesa e vlerësimit konstant të gjendjes, shkakut dhe pasojave ka ndikuar në rritjen e pa arsyeshme të masave restriktive dhe implikimin e kriterëve që ka pamundësuar përfshirjen në masë më të madhe të grave si përfitues të fondeve. Kjo ka qenë edhe si pasojë e mungesës së studimit të çështjeve gjinore, shqyrtimit të kërkesave dhe nevojave të tyre në sektorin bujqësorë.

Raportet e monitorimit nuk ofrojnë informata të mjaftueshme për arritjen e qëllimit të objektivave sipas masave të programit. Raportet përmbajnë të dhëna në përgjithësi për aplikuesit sipas masave, të refuzuarve dhe përfituesve mirëpo jo të ndara sipas gjinisë. Komiteti monitorues nuk ka funksionuar që nga viti 2014. Në mungesë të funksionalizmit të komitetit edhe raportet e monitorimit të programit nuk janë trajtuar dhe aprovuar.

Drejtorja e kontrollës ka shfaqur mangësi në procesin e caktimit të inspektorëve duke i caktuar të njëjtit inspektorë dy herë radhazi, ndërkohë që procedurat e brendshme kërkojnë rotacion të inspektorëve për kontroll. Kontrolla e dytë që bëhet pas investimit nuk kishte identifikuar mungesën e dëshmive për të punësuarit si dhe arsyen e mos zbatimit e të kriterit për të cilin ishte poentuar projekti. prandaj nuk mund të konfirmohet numri i të punësuarve apo hapja e vendeve të reja të punës të parapara në projekt.





---

**REKOMANDIMET**

**05**

## 5. Rekomandimet

**Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural duhet të fuqizojë ndikimin e politikave, programeve dhe masave që synojnë promovimin e përfshirjes së grave nga zonat rurale në tregun e punës që:**

1. Të sigurojë informata të plota mbi nevojat dhe kërkesat specifike të grave në sektorin e bujqësisë duke përfshirën analiza të detajuara dhe gjithëpërfshirëse gjinore në hartimin e programit, duke promovuar barazinë gjinore.
2. Të rishikojë në mënyrë të plotë masat afirmative, të përcaktohen kritere që marrin parasysh rrethanat e ndryshme të grave në zonat rurale.
3. Të luajnë një rol pro aktiv dhe të rriten fushatat e vetëdijesimit gjatë tërë vitit, duke marrë parasysh nevojat dhe sfidat specifike me të cilat përballen gratë në zonat rurale.
4. Të sigurojë funksionalitetin e Komitetit të Monitorimit, përmes mbikëqyrjes së vazhdueshme të programeve. Raportet e monitorimit duhet të përmbajnë më shumë indikatorë analitik të ndara sipas gjinisë për të lehtësuar një vlerësim gjithëpërfshirës të ndikimit të programit.
5. Shpalljet e thirrjeve për aplikim dhe përzgjedhja e aplikuesve të bëhen me kohë, në mënyrë që mos të shkaktohen vonesa në kultivimin/prodhimin e kulturave të ndryshme bujqësore të ndërlidhura me kushtet klimatike.
6. Të zhvillohen mekanizma për shqyrtimin sa më objektiv të aplikacioneve, në veçanti t'iu kushtohet rëndësi procedurave të ankimimit dhe rishqyrtimit në rastet kur procedurat e tilla iniciohen.
7. Të modifikojë sistemin elektronik të të dhënave për regjistrimin dhe përzgjedhjen e përfituesve për të pasqyruar më qartë numrin e aplikuesve gra dhe burra dhe për të siguruar një vlerësim objektiv të bazuar në parimin e barazisë gjinore.
8. Të forcohen kontrollet e brendshme me qëllim të zbatimit adekuat të rregulloreve dhe procedurave, duke përfshirë rotacionin e duhur të inspektorëve, për të identifikuar dhe korrigjuar mangësitë në proces.

**Rekomandojmë ministrin e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve të sigurojë që Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës të:**

1. Përfshijë në raportet e tyre të punësimit dhe aftësimit profesional edhe analiza të ndara sipas gjinisë në zona urbane dhe rurale.
2. Zhvillojë programe trajnimi që plotësojnë nevojat e grave në zonat rurale, duke i bërë ato të qasshme dhe të përshtatura sipas niveleve arsimore.



---

**SHTOJCAT**

# Shtojca 1. Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

## Fushëveprimi i auditimit

Fushëveprimi i këtij auditimi janë:

Agjencia e Punësimit (APRK) në kuadër të së cilës janë zyrat e punësimit dhe qendra e aftësimit profesional.

Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) në kuadër të së cilës janë: departamenti i politikave të zhvillimit rural (Autoriteti Menaxhues) si dhe departamenti i shërbimeve këshillimore dhe teknike.

Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB), në kuadër të së cilës janë: drejtoria për miratimin e projekteve si dhe drejtoria e kontrolleve.

Gjatë auditimit të këtyre dy entiteteve, fokusi kryesor është Programi për bujqësi dhe zhvillim rural, përkatësisht dy masat si në vijim:

- a. *Investimet në pasuritë fizike në ekonomitë bujqësore,*
- b. *Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i biznesit.*

Përzgjedhja e këtyre dy masave është bërë për faktin se përmes tyre, gratë fermere kanë përparësi në përfitimin e granteve investive duke u vlerësuar me pika shtesë.

Auditimi do të mbulojë periudhën 2019 - 2023, megjithëse edhe disa rrethana përpara kësaj periudhe mund të auditohen për të mbledhur të dhëna për kryerjen e analizave krahasuese.

## Metodologjia e auditimit

Për t'iu përgjigjur pyetjeve audituese janë përdorur teknika të ndryshme në mënyrë që të sigurojmë dëshmi të duhura, si:

- *Analizimi i kornizës ligjore dhe rregullative lidhur me barazinë gjinore; mbrojtje ndaj diskriminimit; ligjit për prona dhe të drejta pronësore; trashëgimisë;*
- *Analizimi i kornizës ligjore për Agjencinë e Punësimit;*
- *Analizimi i raporteve vjetore të performancës “ Punësimi dhe Aftësimi Profesional”;*
- *Analizimi i programit për barazi gjinore 2020-2024;*
- *Analizimi i Strategjisë për bujqësi dhe zhvillim rural 2022-2028; Programi për bujqësi dhe zhvillim rural 2014-2020;*
- *Analizimi i raporteve dhe hulumtimeve të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare që ndërlidhen me barazinë gjinore dhe punësimin e grave;*
- *Analizim i programeve për zhvillim rural 2019, 2020-2021, 2022 dhe 2023;*
- *Analizimi i udhëzuesve për aplikim për masa të programit për zhvillim rural;*
- *Analizimi i rregulloreve për detyra, përgjegjësi, kompetenca dhe strukturë organizative të AZHB-së;*
- *Analiza e udhëzuesve administrativ (MBPZHR) për masat dhe kriteret e përkrahjes për zhvillim rural për vitet 2019-2022;*
- *Analizimi i raporteve të monitorimit të cilësisë së zbatimit të PZHR (2020-2021);*
- *Analizimi i të dhënave/statistikave për punësimet për periudhën e auditimit;*
- *Analizimi i raporteve të punës së AZHB-së 2022;*
- *Mostrim në bazë të të dhënave të ofruara nga AZHB.<sup>49</sup> Nga të dhënat kuantitative është bërë përzgjedhja e mostrave sipas shtresimit për gjashtë sektorë nga dy masat e lartëcekura. Mostrimi është bazuar në, metodën e rastit, gjykimin profesional dhe materialitetin më të lartë.*
- *Zhvillimi i anketës me përkrahjen e UN Women, me gra që jetojnë në zonat rurale në Kosovë.*
- *Vizita në terren*
- *Shkëmbime të praktikave me SAI të përfshira në auditim paralel*
- *Dokumentacion tjetër relevant për punën tonë audituese.*

49 Listat e aplikuesve/përfituesve të granteve për të dy masat.

## Shtojca 2. Analizat e kriterëve dhe numri i kontrolleve të përfituesëve

Tabela 12: Kriteret dhe ndryshimi i tyre 2019-2023 për masën 1

1. Masa 1 Investimet në astetet fizike									
Objektivat afatmesme të programit: Permiresimi i cilesis se jetes se banoreve ne zonat rurale nëpërmjet diversifikimit të aktiviteteve në ferma dhe jashtë fermave, me qëllim të krijimit të vendeve të reja të punës dhe rritjes së të ardhurave të banorëve rural.									
Nr	Kriteret e perzgjedhjes Serrat	Poentimi 2019		Poentimi 2020/21		Poentimi 2022		Poentimi 2023	
1	Sipërfaqja e tokes 50-55 ari	50	55	50	55	50	55	50	55
2	Investimet e pranueshme varesisht nga 30.000-60.000	5	8	10	5	8	10		
3	Marredheniet Kontraktuese (nje kontrate valide e lidhur me palet e treta)		3						
4	Mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimi klimatik		2		10		10		10
5	Krijimi i vendeve të reja të punës, sipas UA		10		10		5		20
6	Përkrahja për herë të parë		10		5		10		
7	Pronësia mbi tokën ku bëhet investimi		3*		5*		10*		
8	Përgatitja profesionale	3	5		3				
9	Gjinia e fermerit ( Masa afirmative)		2		2*		2*		2
10	Aplikues i ri (nen moshen 40vj)						3		3
Kriteret e perzgjedhjes Pemtaria (Drufrutore, manore)		2019		2020/21		2022		2023	
1	Siperfaqja e tokes 1 deri 3 hektar		55		55	50	55	50	55
2	Vlera e investimeve të pranueshme 30000-60000	5	8	10	5	8	10		
3	Marredheniet Kontraktuese (nje kontrate valide e lidhur me palet e treta)		3		10				
4	Mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimi klimatik		2		10		10		10
5	Krijimi i vendeve të reja të punës		10				5		20
6	Pronësia mbi tokën ku bëhet investimi		3*		5*		10*		
7	Pergatitja profesionale	3	3	5		3			
8	Investimet në zonat malore						5		10
9	Përkrahja për here të parë		10		5		10		
10	Aplikues i ri ( nen moshen 40 vjec)						3		3
11	Gjinia ( Masa afirmative)		2		2*		2*		2*



Tabela 13: Kriteret dhe ndryshimi i tyre 2019-2023 për masën 302/7

1. Masa 7/302 Diversifikimi I fermave dhe bizneset familjare; Turizmi rural, Prodhimi I mjalitit dhe Artizanalet/ Aktivitete jo bujqesore										
Nr	Kriteret e perzgjedhjes Turizmi rural	Poentimi 2019		Poentimi 2020/21			Poentimi 2022		Poentimi 2023	
1	Përvoja e aplikuesit në turizëm rural (për personat fizik, të përshkruhet në projekt (me NIF) - propozim ose në plan të biznesit; për ndërmarrje, të dëshmohet me çertifikatën e biznesit)	25	35	25	35	50	55	40	45	
2	Vendi i investimit ( Zonat malore)	5	10	5	10		10		15	
3	Lloj i investimeve: Në rast të investimit edhe nga pika a) edhe nga pika b), pikët llogariten nga investimi me pjesën më të madhe të mjeteve (maksimum 20 pikë)	5	10	15	5	10	15			
4	Mosha ( Aplikuesi I ri nen 40vjec)		5		5		5		10	
5	Gjinia		2		2		5		5	
6	Punësimi		10		10		5		5	
7	Përkrahje për herë të parë		10		10					
8	Trashëgimia kulturore		8		8		5		5	
9	Arsimimi		3		3					
10	Përkrahja nga GLV		2		2		5		5	
11	Mbrojtja e mjedisit*						10		10	
Kriteret e perzgjedhjes Prodhimi I mjalitit		2019	2020/21			2022		2023		
1	Madhësia e fermës në momentin e aplikimit*	40	50	40	45	50	45	55	40	45
2	Regjistrimi i biznesit		5		5		5		10	
3	Punësimi		5		5		5		10	
4	Adresa / vendbanimi i aplikuesit**	10	5	5	10		5			
5	Përkrahje për herë të parë		10		10					
6	Gjinia		2		2		5		10	
7	Mosha		5		5		5		5	
8	Arsimimi		5		5					
9	Bujqësia organike		8		8					
10	Mbrojtja e mjedisit*						10		10	
11	Siguria e ushqimit						10			


Kriteret e perzgjedhjes Artizanalet		2019	2020/21	2022	2023		
1	Gjinia e aplikuesit	45	55	10	5	5	
2	Përvoja e aplikuesit në aktivitetet artizanale (për personat fizik (me NIF), të përshkruhet në projekt - propozim ose në plan tbniznesit; për ndërmarrje, të dëshmohet me çertifikatën e biznesit)	10	15	35	40	15	15
3	Mosha ( Aplikues I ri nen 40/ mbi 40 v)	10	10	35	45	35	45
4	Vendi i investimit	5	10	10	15	15	15
5	Punësimi	10	15	10	10	10	10
6	Perkrahja per here te pare			10			

Burimi; Udhëzuesit dhe programet e Zhvillimit Rural, 2019-2023


**Tabela 14: Kontrolltet e kryera gjatë viteve 2019-2023**

Kontrolltet e kryera gjatë viteve 2019-2023					
Aktivitetet e kontrollës	2019	2020	2021	2022	Shtator 2022- Shtator 2023
Kontrolla e dytë për përfituesit të vitit paraprak	302	-	20	9	402
Kontrolla e parë e PZHR-së të vitit përkatës	510	334	418	313	536
Kontrolla e dytë e vitit aktual përkatës	69	372	313	-	-
Ex post kontrolla 2016	349	-	-	-	-
Ex post kontrolla 2017	-	356	-	-	-
Ex post kontrolla 2018	-	-	551	-	-
Ex post kontrolla 2019	-	-	-	58	390
Rikontrolltet	29	8	27	1	8
Ri Ex post kontrolla	25	-	-	104	6
Super kontrolla	2	2	-	-	440
<b>Totali</b>	<b>1,286</b>	<b>1,072</b>	<b>1,329</b>	<b>485</b>	<b>1,782</b>

Burimi: Analizimi i raporteve vjetore të punës, raporteve të kontrolleve të PZHR-së, dhe raporteve të ex-post kontrolleve të drejtorisë së kontrollës pranë AZHB-së

**Grafiku 4: Raporti i ex post kontrollës për përfituesit e masës 101 të vitit 2019**

Burimi: Raporti i monitorimit të ex post kontrolleve të AZHB-së

**Grafiku 5: Raporti i ex post kontrollës për përfituesit e masës 302 të vitit 2019**

Burimi: Raporti i monitorimit të ex post kontrolleve të AZHB-së

# Shtojca 3. Raporti i anketës

## Eksplorimi i mundësive dhe sfidave ekonomike të grave të zonave rurale në Kosovë

### Hyrje

Zyra e UN Women në Kosovë ka angazhuar një kompani për të kryer një anketë me 400 gra që jetojnë në zonat rurale në Kosovë. Qëllimi kryesor i anketës ishte të kuptojë nivelin e njohurive të grave mbi dhe qasjen e tyre në subvencionet dhe grantet qeveritare nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë, dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR). Gjithashtu, anketa kishte për qëllim mbledhjen e të dhënave për nivelin e zhvillimit ekonomik dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, përmes diversifikimit të biznesit, zhvillimit të komunitetit dhe përfshirjes sociale.

Qëllimet specifike të anketës ishin:

- *Vlerësimi i nivelit të punësimit dhe të të ardhurave të grave në zonat rurale*
- *Shqyritimi i faktorëve që kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale*
- *Identifikimi i faktorëve që ndikojnë në shpërnguljen nga zonat rurale në ato urbane*
- *Eksplorimi i potencialit për zhvillim të balancuar ekonomik dhe social në zonat rurale*

Ky raport është i strukturuar në disa seksione. Seksioni i parë ofron një pasqyrë të metodologjisë së anketimit dhe procedurave të mostrimit. Seksionet vijuese paraqesin gjetjet e anketës, duke u fokusuar në fushat kyçe si të dhënat personale dhe të ekonomisë familjare, qasja e grave në informacion, pjesëmarrja në aktivitetet ekonomike dhe përfitimi nga grantet e MBPZhR-së. Raporti përfundon me rekomandime për politikatat dhe intervenimet e ardhshme që synojnë përmirësimin e jetës së grave që jetojnë në zonat rurale në Kosovë.

## Metodologjia

Metodologjia e zhvilluar për anketimin e 400 grave në zonat rurale në Kosovë përdori një qasje të shtresuar në tre faza:

- *Përzgjedhja e njësive të para të mostrës (NPM): Zonat e Anketimit (ZA) në vendabimet rurale të bazuara në qendrat e votimit (QV) shërbyen si grupime gjeografike. QV-të u zgjedhën proporcionalisht me numrin e familjeve në çdo rajon, me përzgjedhje të rastësishme nga lista kombëtare. Hartat e QV-ve të përzgjedhura janë marrë paraprakisht nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ).*
- *Përzgjedhja e ekonomive familjare: Familjet janë përzgjedhur sistematikisht brenda zonave të anketimit. Anketuesit filluan në një pikë të caktuar, ndoqën një rrugë të rastësishme dhe zgjedhën familjet përmes vizitave derë më derë.*
- *Përzgjedhja e të anketuarave: Brenda familjeve, anketa u zhvillua me një grua në familje 18+ vjeç që e kishte festuar ditëlindjen e fundit.*

Megjithatë, sikurse në çdo hulumtim ku mbledhen të dhëna parësore, vlen të theksohen disa kufizime të këtij studimi:


- *Përfaqësueshmëri e kufizuar: Gjetjet e anketës bazohen në një mostër të kufizuar prej 400 grave në zonat rurale të Kosovës dhe mund të mos jenë plotësisht përfaqësuese për të gjithë popullatën e grave që jetojnë në zona rurale në Kosovë.*
- *Madhësia e mostrës dhe niveli i besimit: Sipas regjistrimit të popullsisë së Kosovës, numri i popullsisë së grave mbi 18 vjeç në Kosovë në zonat rurale është 183,794, e cila konsiderohet popullata jonë për këtë hulumtim. Ndërsa anketa synon një nivel besimi prej 95% me një madhësi të mostrës prej 400 grash, marzha e gabimit është 4.89%. Ky informacion është thelbësor për të kuptuar saktësinë dhe besueshmërinë e gjetjeve të anketës dhe interpretimin e rezultateve të hulumtimit.*
- *Njohuritë dhe mbamendja e të anketuarave: Të anketuarat u përballen me sfida duke kujtuar detaje specifike ose duke mos pasur njohuri të mjaftueshme mbi temën, veçanërisht kur bëhet fjalë për aktivitetet ekonomike të ekonomisë familjare ose informacione të lidhura me grantet.*
- *Perceptimi i të anketuarave: Të anketuarat mund të kenë dhënë përgjigje që ato i perceptojnë si përgjigje të dëshirueshme nga rrethi shoqëror, apo nga organizata që realizon anketën në vend që të shprehin përvojat ose opinionet e tyre të vërteta.*

Pavarësisht këtyre kufizimeve, të dhënat e marra ofrojnë njohuri të vlefshme për sfidat dhe mundësitë me të cilat përballen gratë në zonat rurale, duke ofruar një bazë për strategji efektive për të rritur fuqizimin e tyre ekonomik dhe përfshirjen sociale.


## Të dhënat personale

Mostra prej 400 grave që jetojnë në zonat rurale në Kosovë shfaq një shpërndarje proporcionale sipas popullsisë së grave në zonat rurale në shtatë rajonet e Kosovës. Prishtina zë pjesën më të madhe me 22.5%, e ndjekur nga Prizreni (20.0%), Peja (15.0%), Ferizaj (12.5%), Gjilani (10.0%), Mitrovica (10.0%) dhe Gjakova (10.0%). Kjo shpërndarje siguron një përfaqësim të balancuar, duke mundësuar një eksplorim gjithëpërfshirës të perspektivave. Ndërsa, sa i përket etnisë, shumica e grave ishin shqiptare (95.5%) e disa prej tyre i përkisnin komuniteteve jo-shumicë, përkatësisht boshnjake (4.5%).

**Figura 2 Rajoni**




**Figura 3 Etnia**




Duke zbatuar metodën e ditëlindjes së fundit të grave në ekonominë familjare dhe duke marrë parasysh disponueshmërinë e tyre për përgjigje, mostra prej 400 grave rurale në Kosovë është e shpërndarë nëpër grupmosha të ndryshme. Grupmosha 18-24 vjeç zë 12.3% të mostrës, ndjekur nga grupmosha 25-34 vjeç (16.5%), 35-44 vjeç (19.5%), 45-54 vjeç (27.0%), 55-64 vjeç (20.3%), dhe 65 vjeç e lart (4.5%). Ky shtresim kap perspektivat e grave rurale të moshave ndryshme. Shumica e të anketuarave janë të martuara (73.3%), kurse 3.3% bashkëjetojnë me partnerin. Ndërsa 16% janë të pamartuara. Për më tepër, 7.0% janë të veja, dhe 0.5% janë të divorcuara.

**Figura 4 Grupmosha**



**Figura 5 Statusi civil**



Sa i përket numrit të fëmijëve, 20% e grave të anketuara thonë se nuk kanë asnjë fëmijë, 5.8% kanë një fëmijë, dhe 18.3% kanë dy fëmijë. Përgjigja më e zakonshme ishte se kanë tre fëmijë, e raportuar nga 28.8% e të anketuarave. Gjithashtu, 15.5% kanë katër fëmijë, 8.3% kanë pesë, ndërsa 2.3% kanë gjashtë fëmijë. Vetëm disa të anketuara raportuan se kanë shtatë, tetë ose nëntë fëmijë, me përqindje që variojnë nga 0.3% deri në 0.8%. Duhet theksuar se këtu të gjitha gratë u përgjigjën për numrin e fëmijëve të tyre, pavarësisht a janë të rritur apo jo dhe se a janë pjesë e ekonomisë të tashme familjare. Për më tepër, gratë që deklaruan se kanë fëmijë më pas u pyetën nëse kanë fëmijë nën moshën 6 vjeçare dhe 14.1% deklaruan se kanë një fëmijë nën këtë moshë, 6.6% se kanë dy fëmijë nën këtë moshë, dhe 1.3% se kanë tre fëmijë nën këtë moshë.

Figura 6 Numri i fëmijëve

N=400





Figura 7 Numri i fëmijëve nën 6 vjeç


N=320



Për sa i përket nivelit më të lartë të arsimit të përfunduar, të dhënat tregojnë një shpërndarje të larmishme. Përafërsisht 6.3% e të anketuarave kanë deklaruar se nuk kanë përfunduar asnjë nivel të arsimit formal. Pothuajse gjysma (48.5%) kanë përfunduar shkollën fillore (klasat 1-9), ndërsa 26.5% kanë përfunduar shkollën e mesme (gjimnaz). Një pjesë më e vogël, 5.3%, kanë përfunduar shkollën e mesme profesionale. Për më tepër, 10.3% raportuan se kishin përfunduar fakultetin (diplomë Bachelor ose ekuivalentin e saj), dhe 3.3% kanë përfunduar magjistraturën (diplomë Master ose ekuivalentin e saj).




Figura 8 Niveli i përfunduar i arsimit



Të dhënat për statusin aktual të punësimit të të anketuarave tregojnë se 16% e të anketuarave janë aktualisht të punësuar, ndërsa 1.8% janë të vetëpunësuar apo pronare biznesi. Një pjesë e konsiderueshme, që përbën 19.8%, kërkon punë ndërkohë që janë të papuna, ndërsa pjesa më e madhe, me 59.3%, janë të papuna dhe nuk janë në kërkim të punës. Një pjesë e vogël, 0.8% janë pensioniste dhe 2.5% janë studente.

Figura 9 Statusi i punësimit


N=400



Arsyet kryesore për mos kërkimin e punës janë të ndryshme. Kështu, 23.0% e të anketuarave përmendin mungesën e vendeve të punës si një arsye kryesore. Gjithashtu, 30.7% shprehen se fokusi i tyre në kujdesin ndaj fëmijëve është një faktor domethënës, ndërsa 19.4% përmendin kujdesin për të moshuarit dhe anëtarët e tjerë të familjes. 19.2% theksojnë pagat e ulëta si një arsye mbizotëruese. Një përqindje më

e vogël, 2.5%, ia atribuojnë pasivitetin e tyre në punësim çështjeve të shëndetit personal, ndërsa vetëm 1.0% tregojnë për çështje shëndetësore që prekin anëtarët e familjes. Një tjetër 4.2% tregojnë arsye të tjera të ndryshme. Këto përqindje hedhin dritë mbi faktorët e ndryshëm që ndikojnë në vendimet e grave për të mos kërkuar punë.

**Figura 10 Arsyet për mos kërkimin e punës**



Të dhënat për statusin e regjistrimit në Zyrën e Punësimit tregojnë se 19% e të anketuarave janë aktualisht të regjistruara, ndërsa shumica (81%) nuk janë të regjistruara. Për ato të anketuara që nuk janë të regjistruara në Zyrën e Punësimit, arsyet janë të ndryshme. Prej tyre, 7.4% përmendin se janë aktualisht të punësuar ose të angazhuara në biznesin e tyre, 55.6% shprehin mungesë interesi për punë dhe 36.1% përmendin mungesën e njohurive për ekzistencën e Zyrës së Punësimit. Për më tepër, 0.9% deklarojnë se janë tashmë të punësuar duke lënë potencialisht të nënkuptohet se nuk kanë interesim për punë tjetër.

Figura 11 Regjistrimi në Zyrën e Punësimit






Figura 12 Arsyet për mos regjistrimin në Zyrën e Punësimit



\*vetëm ato që nuk janë të regjistruara në Zyrë të Punësimit

Të dhënat për përvojën e punës tregojnë se një përqindje e konsiderueshme e të anketuarave kanë nivele të ndryshme të përvojës së punës. Veçanërisht, 67.3% nuk kanë përvojë të mëparshme pune (0 vite përvojë pune). Më tej, të dhënat tregojnë se 21.5% kanë përvojë pune 1-5 vjet, 6.3% kanë 6-10 vjet dhe përqindje më të vogla kanë përvojë që variojnë nga 11 deri në 30+ vjet.


Figura 13 Përvoja e punës në vite



Kurse, 63.3% e grave të martuara apo që bashkëjetojnë me dikë, tregojnë se burrat e tyre punojnë. Megjithatë, duhet theksuar se anketa nuk ka mbledhur detaje për sektorin e punësimit, formalitetin, apo edhe për vendin se ku punojnë ata.

**Figura 14 Punësimi i burrit apo partnerit me të cilin bashkëjeton**


N=306



Sfidat kryesore që pengojnë gratë në zonat rurale për t'u angazhuar në punësim janë të ndryshme, siç pasqyrohet në rezultatet e anketës. Një përqindje e konsiderueshme (35.5%) identifikojnë mungesën e mundësive për punë si sfidën kryesore. Për më tepër, 27% përmendin përgjegjësitë e kujdesit ndaj fëmijëve si një pengesë kryesore, ndërsa 7.5% përmendin nevojën për t'u kujdesur për të moshuarit dhe anëtarët e tjerë të familjes. Përgjegjësitë shtëpiake, të përfshira në punët e shtëpisë, janë identifikuar nga 15.3% e të anketuarave si një sfidë e rëndësishme. Për më tepër, 10.3% theksojnë mungesën e transportit publik si pengesë për punësimin. Një përqindje më e vogël, 4.5%, ia atribuojnë sfidat arsyeve të tjera. Këto gjetje ofrojnë njohuri të vlefshme për pengesat specifike me të cilat përballen gratë në mjediset rurale në kërkimin e tyre për punësim.

**Figura 15 Perceptimi mbi sfidat kryesore që pengojnë gratë në fshatra të punojnë**


N=400



## Të dhënat për ekonominë familjare dhe aktivitetin ekonomik

Të dhënat për madhësinë e familjes ilustrojnë një shpërndarje të larmishme ndërmjet pjesëmarrëseve të anketuara. Pothuajse një e katërta (24%) e të anketuarave kanë familje të përbërë nga 5 anëtarë, duke e bërë atë madhësinë më të zakonshme të familjes. Pas kësaj, 20.8% raportojnë se kanë 6 anëtarë të familjes, ndërsa 18.0% kanë 4 anëtarë. Më tej, shpërndarja përfshin familjet me 3, 7 dhe 2 anëtarë, secila me përkatësisht 12.3%, 11.3% dhe 4.8%. Përqindje më të vogla përfaqësojnë familjet me 1, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 15 dhe 20 anëtarë. Këto përqindje të vlefshme, të nxjerra nga përgjigjet e 400 pjesëmarrësve, ofrojnë një pamje gjithëpërfshirëse të madhësive të ndryshme të ekonomive familjare brenda popullsisë së anketuar.


Figura 16 Numri i anëtarëve të familjes




Shpërndarja e anëtarëve të familjes të punësuar aktualisht, duke përfshirë edhe veten, ofron njohuri mbi dinamikën e punësimit brenda familjeve. Një pjesë e konsiderueshme prej 46.3% raportojnë se vetëm një anëtar/e i/e familjes, duke përfshirë edhe veten, është aktualisht i/e punësuar. Gjithashtu, 29.0% përmendin se dy anëtarë të familjes punojnë, ndërsa 11.8% kanë tre anëtarë të familjes të punësuar. Përqindje më të vogla përfaqësojnë familjet me katër, pesë ose pa anëtarë të punësuar. Koncretisht, 2.3% kanë katër anëtarë të punësuar, 1.3% kanë pesë, dhe 9.5% raportojnë se nuk kanë anëtarë të punësuar të familjes.

**Figura 17 Numri i anëtarëve të familjes të punësuar**

N=400




Të dhënat për pronësinë e tokës për bujqësi brenda familjeve të anketuara tregojnë se një pjesë e konsiderueshme prej 77.5%, pohojnë posedimin e tokës bujqësore. Në anën tjetër, 22.5% raportojnë se familjet e tyre nuk posedojnë tokë për aktivitete bujqësore..

**Figura 18 Posedimi i tokës për bujqësi**


Të dhënat për sipërfaqen e tokës në ari janë të ndryshme. Kështu, 21.0% e të anketuarave raportojnë se posedojnë tokë me sipërfaqe që varion nga 1 deri në 10 ari, ndërsa 12.6% kanë përmasa tokësore midis 91 dhe 100 ari. Përqindje të tjera të rëndësishme përfshijnë 11% me madhësi të tokës midis 101 dhe 200 ari, dhe 11.9% midis 41 dhe 50 ari. Përqindjet më të vogla përfaqësojnë kategori të ndryshme të madhësisë së tokës, duke përfshirë ato që nuk e dinë madhësinë e saktë. Këto të dhëna ofrojnë njohuri të vlefshme për diversitetin e përmasave të tokës bujqësore në pronësi të familjeve të anketuara.

Figura 19 Sipërfaqja e tokës në ari




Të dhënat mbi pronësinë e tokës, konkretisht nëse e anketuara apo ndonjë grua në familje është pronare apo bashkëpronare e tokës, tregojnë se 4.8% e të anketuarave pohojnë pronësinë apo bashkëpronësinë. Anasjelltas, shumica, 72.8%, raportojnë se nuk janë pronare apo bashkëpronare as vetë as ndonjë grua në familje. Këto përqindje, të nxjerra nga përgjigjet e 400 pjesëmarrëseve, ofrojnë njohuri mbi shpërndarjen e pronësisë së tokës brenda popullsisë së anketuar dhe nxjerrin në pah nevojën për eksplorim të mëtejshëm në lidhje me individët e përfshirë në pronësinë e tokës brenda kontekstit familjar.

Figura 20 Pronësia apo bashkëpronësia e tokës nga gratë e familjes



Grave që deklaruan se familjet e tyre posedojnë tokë iu kërkua më tej të elaborojnë se çfarë kultivojnë. Rezultatet tregojnë se 50.8% e tyre kultivojnë grurë, duke e bërë atë kulturën më të përmendur me përqindjen më të lartë në total. Pas grurit, 40% e pjesëmarrësve raportojnë kultivimin e perimeve. Gjithashtu, disa pjesëmarrës përmendin kultivimin e pemëve, kungujve, bostanit, sanës, lajthive dhe vreshtave. Është e rëndësishme të theksohet se disa pjesëmarrës mund të kenë përmendur më shumë se një kulturë. Ky informacion ofron një pasqyrë të përgjithshme të llojeve të ndryshme të kultivimeve në tokat e familjeve të të anketuarave.

Figura 21 Kultivimi i kulturave në tokë bujqësore



Të dhënat për angazhimin në sektorë të zhvillimit rural zbulojnë informata të rëndësishme. Diku 45.4% të familjeve merren me bujqësi, 13.2% fokusohen në blegtori, ndërsa 9.8% merren me shpeztari, Kurse, 31.4% raportojnë se nuk janë angazhuar në këta sektorë, duke vënë në dukje mënyrat e ndryshme të jetesës në zonat rurale. Këto gjetje nënvizojnë rëndësinë e bujqësisë dhe shfaqin aktivitetet e ndryshme ekonomike që formësojnë zhvillimin rural.

Figura 22 Veprimtaritë e zhvillimit rural në të cilat ekonomia familjare është e angazhuar




Tabela më poshtë ofron një përmbledhje të aktiviteteve specifike brenda sektorëve të ndryshëm. Në sektorin e blegtorisë, 10.4% e të anketuarave janë të përfshirë në bletari dhe kujdes të bletëve. Ndërsa, një pjesë e konsiderueshme (89.6%) fokusohet në kujdesin dhe rritjen e kafshëve si lopët, delet dhe dhitë. Në bujqësi, 97.3% merren me kultivimin e perimeve për konsum. Kurse, vetëm 2.7% kultivojnë produkte bujqësore posaçërisht për nevojat e kafshëve të tyre. Në sektorin artizanal, një e anketuar ka deklaruar se janë të përfshirë në rrobaqepësi.




**Tabela 15 Veprimtaritë specifike të zhvillimit rural në të cilat ekonomia familjare është e angazhuar**

Veprimtaria specifike	Blegtori (N=67)	Bujqesi (N=223)	Artizanale (N=1)
Mbajtja dhe kujdesi ndaj bleteve	10.4%		
Mbajtja dhe rritja e kafsheve (lope, dele, vic)	89.6%		
Mbjellja dhe kultivimi i perimeve për konsum		97.3%	
Mbjellja dhe kultivimi i produkteve bujqesore për nevojat e kafsheve		2.7%	
Rrobaqepesi			100%

Të dhënat për qëllimin e produkteve që rezultojnë nga aktivitetet e ekonomive familjare nxjerrin në pah se 62.5% e tyre kultivojnë artikuj për konsum familjar, 7.1% për shitje dhe 30.4% si për konsum personal ashtu edhe për shitje.

**Figura 23 Përdorimi i produkteve nga veprimtaria e ekonomisë familjare në zhvillim rural**

N=240



Ndarja e angazhimit të anëtarëve të familjes në aktivitetet e specifikuara, tregon se 0.8% raportojnë se nuk kanë përfshirë anëtarë të familjes (këto dy raste kanë deklaruar të punësojnë punëtorë sezonalë për nevojat e tyre për të punuar tokën dhe asnjë familjar nuk është i angazhuar), ndërsa 25% kanë një anëtar të angazhuar, 51.3% dy anëtarë, 15.8% tre anëtarë, 4.2% katër anëtarë, dhe 2.5% kanë pesë anëtarë që marrin pjesë në aktivitete.


**Figura 24 Numri i anëtarëve të familjes të punësuar/angazhuar në aktivitete të veprimtarive të zhvillimit rural**


Tabela më poshtë përshkruan shpërndarjen e anëtarëve të familjes të angazhuar në aktivitete të caktuara, duke theksuar dallimet mes burrave dhe grave. Veçanërisht, 13.3% e familjeve nuk angazhojnë burrat në veprimtari të ndërlidhura me zhvillimin rural dhe 21.7% e tyre nuk përfshijnë gra, duke treguar një segment të familjeve ku asnjë anëtar i familjes nuk kontribuon. Shumica e familjeve kanë një anëtar të vetëm të familjes të angazhuar (63.8% kanë një burrë të angazhuar dhe 67.1% kanë një grua të angazhuar). Një përqindje e dukshme e familjeve përfshijnë nga dy anëtarë burra (18.3%) të familjes dhe dy anëtare gra të familjes (9.6%). Një përqindje më e vogël e shtrin angazhimin në tre anëtarë të familjes (3.8% për burrat dhe 1.7% për gratë), ndërsa rastet me katër ose më shumë anëtarë të angazhuar janë të pakta. Në përgjithësi, tabela ofron të dhëna për nivelet e ndryshme të angazhimit të anëtarëve të familjes sipas gjinisë në aktivitetet e veprimtarive të zhvillimit rural.

**Tabela 16 Numri i anëtarëve burra dhe gra të familjes të punësuar/angazhuar në aktivitete të veprimtarive të zhvillimit rural**

Numri i të anëtarëve të angazhuar	Burra të familjes		Gra të familjes	
	N	%	N	%
Asnjë anëtar	32	13.3%	52	21.7%
1 anëtar	153	63.8%	161	67.1%
2 anëtarë	44	18.3%	23	9.6%
3 anëtarë	9	3.8%	4	1.7%
4 anëtarë	1	0.4%		
5 anëtarë	1	0.4%		
6 anëtarë				
Total	240	100%	240	100.0%


Të dhënat për punëtorët sezonalë tregojnë se 92.5% e të anketuarave kanë raportuar se nuk kanë punëtorë sezonalë, ndërsa 5.8% kanë një punëtor sezonal dhe 1.3% kanë dy punëtorë sezonalë. Gjithashtu, 0.4% përmendën se kanë tre punëtorë sezonalë.

**Figura 25 Numri i punëtorëve sezonal të punësuar/angazhuar në aktivitete të veprimtarive të zhvillimit rural**




Të dhënat për bizneset e regjistruara familjare tregojnë se 21.7% e të anketuarave kanë biznese familjare të regjistruara, ndërsa pjesa më e madhe, me 78.3%, nuk kanë biznese të regjistruara familjare.

**Figura 26 Posedimi i biznesit të regjistruar nga ekonomia familjare**




Nga analiza e sektorit në të cilin angazhohen bizneset familjare të regjistruara rezulton se pjesa më e madhe e tyre, me 78.8%, operojnë në sektorin e bujqësisë, pylltarisë dhe peshkimit, bazuar në kodet NACE. Gjithashtu, një përqindje më e vogël është përfshirë në sektorin e prodhimit (7.7%), Po aq janë të përfshirë në tregti me shumicë dhe pakicë, riparim automjesh dhe motoçikletash (7.7%), Ndërsa nga 1.9% e tyre deklarohen se biznesi është i përfshirë në aktivitete akomodimi dhe shërbimesh ushqimi, ndërtimtari, dhe aktivitete financiare dhe sigurimesh.

**Figura 27 Aktiviteti ekonomik (sipas kodeve NACE Rev 2) të bizneseve të regjistruara të ekonomive familjare**



Vetëm 9.6% e grave janë pronare bizneseve të ekonomive familjare të tyre, kurse 90.4% të rasteve janë burrat ata që kanë pronësi mbi këto biznese. Sa i përket përvojës si pronare biznesi, prej grave që janë pronare, qoftë vetë apo një grua tjetër në familje, një grua ka 1 vit që është pronare e biznesit, njëra ka 2 vite që është pronare biznesi, dy gra kanë 5 vitë që janë pronare biznesi dhe një ka 10 vite në këtë rol.

**Figura 28 Pronësia e bizneseve të regjistruara të ekonomive familjare**



Shpërndarja e numrit të punëtorëve në bizneset e regjistruara, e kategorizuar sipas orareve, gjegjësisht me orar të plotë dhe me gjysmë orar, tregon se nga bizneset me të punësuar të regjistruar, 28.8% nuk kanë asnjë punëtor me orar të plotë, ndërsa 55.8% kanë një punëtor me orar të plotë. Për më tepër, 7.7% kanë dy punëtorë me orar të plotë dhe 1.9% secili kanë tre dhe katër punëtorë me orar të plotë. Për sa i përket punësimit me gjysmë orar, 55.8% e bizneseve nuk kanë punëtorë me gjysmë orar, 38.5% kanë

një punëtor me gjysmë orar dhe 5.8% kanë dy punëtorë me gjysmë orar. Kjo ndarje ofron informata mbi modelet e personelit brenda bizneseve të regjistruara, duke theksuar mbizotërimin e orarit të plotë.

**Tabela 17 Numri i punëtorëve në bizneset e regjistruara të ekonomive familjare**

Numri i punëtorëve në biznesin e regjistruar	Me orar të plotë		Me gjysmë orar	
	N	%	N	%
Asnjë punëtor	15	28.8%	29	55.8%
1 punëtor	29	55.8%	20	38.5%
2 punëtorë	4	7.7%	3	5.8%
3 punëtorë	1	1.9%		
4 punëtorë	1	1.9%		
5 punëtorë	2	3.8%		
Total	52	100%	52	100.0%

Të dhënat në lidhje me posedimin e një Numri Identifikues të Fermerit (NIF) në ekonomitë familjare tregojnë se 0.5% e të anketuarave kanë NIF-in e tyre, 23.8% raportojnë se një anëtar burrë i familjes ka një të tillë dhe 0.8% përmendin një anëtare grua të familjes që ka një NIF. Megjithatë, pjesa më e madhe (67%), deklarojnë se askush në familjen e tyre nuk ka NIF, ndërsa 8% janë të pasigurt. Për ata pa NIF, arsyet ndryshojnë. Arsyet më të zakonshme përfshijnë 45.5% që nuk kanë tokë në emër të tyre, 47.5% shprehin mungesë interesi dhe 2.5% përmendin arsye të tjera.

**Figura 29 Posedimi i Numrit Identifikues të Fermerit (NIF), sipas anëtarëve të familjes**

N=400





Figura 30 Arsyet e mos posedimit të Numrit Identifikues të Fermerit (NIF)

N=398



### Informimi dhe përfitimi nga grantet e MBPZhR-së

Të dhënat për ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen në grantet bujqësore nga Ministria e Bujqësisë tregojnë se 67.3% e të anketuarave janë në dijeni për grante të tilla, ndërsa 32.8% jo. Sa i përket aplikimit, 12% e të anketuarave (ose familjarëve të tyre) kanë aplikuar për këto grante, ndërsa shumica, (88%) jo. Në mesin e atyre që aplikuan, shumica (83.3%) kishin një anëtar të familjes burrë si aplikant, 10.4% aplikuan vetë dhe 6.3% kishin një anëtare të familjes grua si aplikante. Megjithatë, kur bëhet fjalë për suksesin e aplikimeve, të dhënat tregojnë një ndarje të barabartë, ku 50.0% deklarojnë se kanë marrë grantin, dhe 50.0% e mbetur raportojnë aplikime të pasuksesshme. Nga total mostra, del se 6% (24 nga 400) e të anketuarave apo familjarëve të tyre kanë përfituar grant.

Figura 31 Informimi rreth dhënies së granteve nga MBPZhR

N=400






Figura 32 Aplikimi për grante nga MBPZhR

N=400



**Figura 33 Aplikanti/ja për grant nga MBPZhR**

N=48

**Figura 34 Përitimi i grantit nga MBPZhR**


N=48



Për sa i përket vitit të përfitimit të grantit, të anketuarat raportuan vite të ndryshme, ku përmendeshin 2016, 2018, 2019, 2020, 2021, 2022 dhe 2023. Të dhënat tregojnë se 25.0% e granteve janë marrë në vitin 2021, 16.7% në vitin 2020, kurse nga 12.5% në vitet 2019, 2022 dhe 2023. Nga 9.3% përmendin vitet 2016 dhe 2018, kurse 4.2% nuk e dinë apo mbajnë mend vitin e përfitimit.

**Figura 35 Viti i përfitimit të grantit**


N=24



Sa i përket vlerës së grantit, të anketuarat raportuan shifra të ndryshme që varionin nga 300 euro në 10,000 euro. Shumat më të zakonshme ishin 5000 euro (16.7%), 10,000 euro (8.3%), 2000 euro (8.3%) dhe 1000 euro (8.3%). Veçanërisht, 33.3% e pjesëmarrësve ose nuk e dinin shumën e grantit ose refuzuan ta zbulonin atë.

Figura 36 Vlera e grantit të përfituar


N=24



Të anketuarat ose anëtarët e familjeve të tyre kanë marrë grante për qëllime të ndryshme, duke përfshirë pajisje për bujqësi (20.8%), produkte bujqësore (25.0%), bletë ose pajisje të punës për bletari (12.5%), serra (12.5%) dhe bagëti (specifikisht, lopë) (29.2%). ë dhënat tregojnë diversitetin e përdorimit të granteve në ekonomitë familjare të të anketuarave, duke ofruar informata për sektorët dhe aktivitetet specifike që përfitojnë nga këto grante.




Figura 37 Gjërat për të cilat është përfituar granti



Të anketuarat që kanë marrë grante kanë raportuar se kanë investuar në aspekte të ndryshme të aktiviteteve të tyre bujqësore. Të dhënat tregojnë se 37.5% kanë investuar në pajisjet e nevojshme për veprimtarinë e tyre, ndërsa 33.3% kanë ndarë grantet e tyre për produktet e nevojshme për mbjellje apo përkujdesje të kafshëve. Gjithashtu, 25% i drejtuan investimet e tyre drejt ndërtimit të hapësirave për lopë, bletë apo produkte bujqësore. Një përqindje më e vogël, 4.2%, zgjodhi të përdorte grantin për marrjen me qira të tokës për mbjellje. Ky informacion ofron njohuri të vlefshme në fushat specifike ku fondet e granteve janë përdorur për të përmirësuar praktikat bujqësore dhe për të mbështetur jetesën e individëve të anketuar.

Figura 38 Gjërat në të cilat është investuar granti i përfituar




Grantet nuk duket të kenë ndikuar në punësim, ngase, shumica nuk kanë punësuar punëtorë të rinj (75%). Megjithatë, 25% kanë punësuar nga një punëtor të ri (25%). Prej atyre që kanë punësuar, në dy raste janë punësuar gra dhe në katër raste janë punësuar burra. Kurse, sa i përket pikëve shtesë, në

rastet kur gruaja ka qenë aplikante për grant (vetëm 8 raste), në 75% të rasteve kanë deklaruar se kanë fituar pikë shtesë, ndërsa në 25% kanë deklaruar se jo.

Ndër të anketuarat që aplikuan për grante dhe u përballën me refuzim ndonjëherë, arsyet për refuzimin e grantit ndryshojnë. Një pjesë e konsiderueshme (30.6%) raportuan se nuk u ishte dhënë një arsye specifike për refuzimin. Rreth 22.2% treguan se toka nuk ishte e regjistruar në emër të tyre apo të familjes së tyre, ndërsa 33.3% përmendën mosplotësimin e kriterëve, siç janë mungesa e tokës, dokumentacionit apo burimeve ujore. Një përqindje më e vogël, 5.6%, shprehin besimin se grantet nuk janë shpërndarë në mënyrë të drejtë. Për më tepër, 8.3% cituan arsye të tjera për refuzimin. Këto gjetje theksojnë sfidat dhe çështjet me të cilat përballen aplikantët gjatë procesit të aplikimit për grant, duke theksuar fushat që mund të kenë nevojë për vëmendje për përmirësim.

**Figura 39 Arsyet për mos përfitimin e grantit (kurdo)**


N=36



Atyre që nuk kanë aplikuar për grante iu kërkua të elaboronin mbi arsyet për mos aplikim. Arsyet për mos aplikim për grante ndryshojnë në mesin e të anketuarave, me 2.8% që shprehin synimet për të aplikuar në të ardhmen. Përafërsisht 6% përmendën pronësinë e pamjaftueshme të tokës, ndërsa 7.4% përmendën mungesën e plotë të tokës. Një pjesë (22.2%) e dukshme raportuan mungesë interesi apo nevoje dhe 9.4% deklaruan se nuk ishin shumë të përfshirë në bujqësi. Rreth 8.8% kanë përmendur mungesën e informacionit të mjaftueshëm dhe 5.1% kanë thënë se nuk i plotësojnë kushtet e kërkuara. Gjithashtu, 18.2% ose nuk i dinin arsyet ose nuk kishin një arsye specifike për të mos aplikuar. Këto përgjigje të ndryshme nxjerrin në pah faktorët e shumanshëm që ndikojnë në vendimet e individëve për të mos aplikuar për grante, duke ofruar informata të vlefshme për përmirësimin e shtrirjes së informatave rreth programeve të subvencionimit dhe granteve nga institucionet publike.

**Figura 40 Arsyet për mos aplikim për grante nga MBPZhR**


N=352




### Qasja në shërbime këshilluese dhe trajnime

Në mesin e të anketuarve, 34.8% janë në dijeni të këshillimeve për bujqësi të ofruara nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR). Nga ana tjetër, 65.3% e të anketuarve nuk janë në dijeni të tyre. Kurse, sa i përket pjesëmarrjes në trajnime apo këshillime nga MBPZhR, vetëm 3.3% kanë marrë pjesë në to. Ky informacion nënvizon nevojën për përpjekje të synuara për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të inkurajuar pjesëmarrjen më aktive në këto programe të vlefshme. Prej atyre që kanë marrë pjesë (vetëm 13 prej tyre), 15.4% kanë qenë mesatarisht të kënaqur/neutral me trajnimet dhe 84.6% shumë të kënaqur.

**Figura 41 Informimi dhe pjesëmarrja në trajnime apo këshillime nga MBPZhrR**




**Figura 42 Niveli i kënaqësisë me trajnimet e MBPZhrR-së**




Të dhënat tregojnë se 15.5% e të anketuarave janë të informuar për mundësitë e trajnimit profesional që ofron Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës (APRK), dhe 11.3% kanë marrë pjesë në këto trajnime. Në anën tjetër, 84.5% e të anketuarave nuk janë të informuara për mundësitë e tilla të trajnimit, dhe 88.7% nuk kanë marrë pjesë në asnjë trajnim profesional të organizuar nga APRK-ja.

**Figura 43 Informimi dhe pjesëmarrja në trajnime profesionale nga APRK**

N=400



N=62




## Interesimi për fillimin e veprimtarive ekonomike

Sa i përket interesit për fillimin e veprimtarive ekonomike, të dhënat tregojnë se 21.5% e të anketuarave shprehin prirje pozitive, duke treguar interes për fillimin e një veprimtarie të re ekonomike. Anasjelltas, shumica, që përbën 78.5% të të anketuarave, aktualisht nuk kanë synime të tilla. Kjo pasqyrë e aspiratave të të anketuarave mund të informojë strategjitë dhe mekanizmat mbështetës për të inkurajuar dhe lehtësuar iniciativat ekonomike brenda popullsisë së anketuar.

Figura 44 Interesimi për fillimin e ndonjë veprimtarie ekonomike


N=400



Sa i përket llojit të veprimtarisë ekonomike që do të dëshironin të fillonin, interesimi më i lartë qëndron në aktivitetet bujqësore, ku 36% shprehin dëshirën për t'u angazhuar në aktivitete si mbjellja dhe kultivimi i pemëve dhe perimeve. Gjithashtu, 12.8% janë të interesuara për mbajtjen dhe rritjen e bletëve, ndërsa 7% shprehin interes për gatimin tradicional. Për më tepër, 15.1% shprehin dëshirën për të krijuar sallone bukuri, duke u fokusuar tek estetika. Një përqindje më e vogël, 9.3%, është e interesuar për t'u angazhuar në aktivitete që lidhen me mbajtjen dhe rritjen e lopëve, dhe 5.8% mbajtjen dhe rritjen e pulave. Aktivitetet e tekstilit dhe veshmbathjes (7%), si dhe interesat e tjera të ndryshme, janë gjithashtu të përfaqësuara.

**Figura 45 Lloji i veprimtarisë ekonomike që do të dëshironin të fillonin**


N=86



Rezultatet e anketës tregojnë se në mesin e të anketuarave që do të dëshironin të fillonin një veprimtari ekonomike, ka kërkesa për forma të ndryshme mbështetjeje. Për sa i përket mbështetjes së nevojshme, 48.6% e të anketuarave shprehën nevojën për pajisje pune, duke theksuar rëndësinë e të pasurit të pajisjeve të duhura për aktivitetet e tyre. Për më tepër, 32.8% e të anketuarave identifikuan një kërkesë për materiale shpenzuese. Kurse, 36.4% e të anketuarave shprehën interes për trajnime, duke theksuar rëndësinë e perceptuar të zhvillimit të aftësive dhe përmirësimit të njohurive. Megjithatë, vetëm një përqindje minimale (1.1%) kanë treguar nevojën për ndihmë financiare. Të dhënat sugjerojnë një grup kërkesash të ndryshme, me një theks veçanërisht të fortë në pajisjet e punës dhe materialet shpenzuese të nevojshme për fillimin e veprimtarive ekonomike.

**Figura 46 Mbështetja e nevojshme për fillimin e një veprimtarie ekonomike**

N=117



\*pyetje me shumë përgjigje

Lidhur me nevojën për trajnime specifike për të ndihmuar në gjetjen e një pune, anketa zbuloi se 11.3% e të anketuarve (45 individë) e pranuan një nevojë të tillë, duke treguar një interes për të fituar aftësi që mund të rrisin punësueshmërinë e tyre. Përkundrazi, shumica, e përbërë nga 88.8% e të anketuarve (355 individë), u shprehën se nuk e perceptojnë nevojën për trajnime specifike për të gjetur punë.

**Figura 47 Nevoja për trajnime për gjetjen e një pune**


N=400



Për ato të anketuara që shprehën nevojën për trajnime specifike (45 individë), anketa eksploroj llojet e trajnimit që ato i konsideronin të dobishme. Përgjigjet treguan një shumëllojshmëri interesash, me 20% që shprehin dëshirën për trajnim në kultivimin cilësor të pemëve dhe perimeve, dhe një përqindje ekuivalente shprehin interes për trajnime lidhur me punën në sallone bukurie. Për më tepër, 11.1% e të anketuarve shprehin interes për trajnime për bletarinë, tekstil dhe rrobaqepësi, për gatim/përgatitjen e ushqimit dhe kujdesin për kafshët. Për më tepër, 20% e të anketuarve kanë treguar interes për lloje të tjera të trajnimeve.

Figura 48 Llojet e trajnimeve të nevojshme për gjetjen e një pune


N=45



Gjetjet e anketës në lidhje me ndërgjegjësimin për mundësitë e granteve nga MBPZhR zbuluan se 20% e të anketuarave e dinw se mund të aplikojnë për grante për qiramarrje nëse pronari i tokës dhe aplikuesi janë në marrëdhënie bashkëshortore apo në vijë të drejtë të gjakut pa kufij (p.sh.: stërgjyshërit, gjyshërit, prindërit, fëmijët, nipërit, mbesat, e kështu me radhë.) dhe kjo dëshmohet përmes certifikatës së martesës apo certifikatës së lindjes dhe/apo certifikatës së vdekjes. Në anwn tjetwr, shumica, që përbën 80% e të anketuarave, shprehën se nuk ishin nw dijeni për këtë dispozitë të veçantë. Kjo pasqyrë sugjeron se ekziston një segment i popullsisë së anketuar që mund të përfitojë potencialisht nga ky informacion nëse bëhet më gjerësisht i disponueshëm.

Figura 49 Njohuritë rreth asaj se mund të aplikojnë për grante në MBPZhR dhe nuk kanë nevojë për qiramarrje nëse pronari i tokës dhe aplikuesi janë në marrëdhënie bashkëshortore apo në vijë të drejtë të gjakut pa kufij


N=400






Kur u pyetën për dhënien e pikëve shtesë për gratë aplikante dhe/ose pronare biznesi në kontekstin e aplikimeve për grante për bujqësi, rezultatet e anketës zbuluan se 26.5% e të anketuarve ishin në dijeni të kësaj politike, duke pranuar se gratë marrin pikë shtesë gjatë procesit të vlerësimit. Në anën tjetër, 73.5% e të anketuarave nuk ishin në dijeni të kësaj politike. Kjo pabarazi nxjerr në pah nivele të ndryshme të ndërgjegjësimit në lidhje me konsideratat e lidhura me gjininë në procesin e aplikimit për grante, të cilat mund të ndikojnë në strategjitë e aplikimit në të ardhmen.

**Figura 50 Njohuritë rreth asaj se për grante për bujqësi, kur gratë janë aplikante ose/dhe pronare të biznesit fitojnë pikë shtesë gjatë vlerësimit**



# Shtojca 4. Letër konfirmimi dhe komentet e entitetit

 <b>Republika e Kosovës</b> Republika Kosova - Republic of Kosovo Qeveria - Vlada - Government Ministria e Financave, Punës dhe Transferëve Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera Ministry of Finance, Labour and Transfers			
 <b>AGJENCIA E PUNËSIMIT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS</b> AGENCIA ZA ZAPOSŁJAVANJE REPUBLIKE KOSOVO AGENCY OF EMPLOYMENT OF THE REPUBLIC OF KOSOVO AGENCIA E PUNËSIMIT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS AGENCIA ZA ZAPOSŁJAVANJE REPUBLIKE KOSOVO EMPLOYMENT AGENCY OF THE REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA QENDRORE E AGJENCISË - CENTRALNO SEDISHTO AGJENCIE CENTRAL OFFICE OF THE AGENCY Prishtine, Republika e Kosoves Prishtine, Republika e Kosovës Pristina, Republic of Kosovo Pristina, Republika e Kosovës 115 15 02 2024			
<b>LETËR E KONFIRMIMIT</b>			
REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE DATE: 15-02-2024 DATUM: 15-02-2024			
Nivësi Org. Org. Jedin. Org. Unit 06	Shif. klasif. Klasif. Kod Class. Code 47	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No. 144	Nr. faqeve Br. Stranica No. Pages 1

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të performancës **“Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale përmes përfshirjes së tyre në tregun e punës”**, dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit


Vendi dhe data: Prishtinë, 15.02.2024

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit **“Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale përmes përfshirjes së tyre në tregun e punës”** (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Zy. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Punësimit  
 Jehona Rexha



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATA/PRILIDHJA/DATE: 27-02-2024			
Njësia Org. Jedin. Org. Unit	Shif. Klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. I faqeve Br. Stranica No. Pages
06	47	196	1



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO MINISTERIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT Arkivi Qendror - Centralna Arhiva - Central Archive	
Nr./Br./No.	862
Nr. i fq./Br. Str./No. pg.	1
Data/Datum/Date:	27.02.2024
PRISHTINE - PRISTINA - PRISTINA	

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
 QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTERIA BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
 MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA  
 MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

#### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të performancës **“Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale përmes përfshirjes së tyre në tregun e punës”**, dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Vendi dhe data: 26.02.2024

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit **“Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale përmes përfshirjes së tyre në tregun e punës”** (në tekstin e mëtejshëm **“Raporti”**);
- pajtohem pjesërisht me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Faton PEÇI

Ministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR)





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**Auditimi i kryer:** “Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale përmes përfshirjes së tyre në tregun e punës”

**Dokumenti:** Komentet nga institucioni i audituar në draft raportin e auditimit

Të gjeturat	Pajtohem po/ jo	Komentet nga Institucioni i audituar në raste të mospajtimit	Pikëpamja e ZKA-së
E gjetura 3.2.1	Jo	Shpallja e thirrjes për aplikim varet nga miratimi i programit dhe U/A për vitin përkatës nga MBPZHR. Ndërsa AZHB është vetëm zbatues i programit.	E gjetura qëndron pasi që është elaboruar se vonesat e shpalljeve të thirrjeve për aplikim kanë ndodhur për shkak të vonesave të miratimit të programeve.
E gjetura 3.2.2	Jo	AZHB ka program elektronik dhe është në procesë të zhvillimit të programit elektronik të granteve dhe tani mund të identifikohet numri i sakt i aplikuesve femra dhe meshkuj. Te gjithë aplikuesit i nënshtrohen procedurave të njejta në kontrollen administrative dhe vlerësimin sipas kriterëve të vendosura në U/A për vitin përkatës. Së i përket çështjes së politikave mbi krijimin e kushteve për favorizim ndërmejt gjinive i takon MBPZHR-së.	E gjetura qëndron pasi që fushëveprimi i auditimit ka qenë periudha 2019-2023 dhe gjendja ka qenë siç është përshkruar në raport. E gjetura ka për synim përmirësimin e sistemit të përzgjedhjes dhe objektivitetin e trajtimit të aplikacioneve gjatë shqyrtimit të tyre sipas plotësisht të kriterëve të pranueshmërisë. Në raport flitet për detajet ku ka pasur ngecje funksionimi i sistemit. Nëse dhjetë veta në sistem elektronik kanë pikë të barabarta edhe përzgjedhja e përfituesve sipas gjinisë duhet të jetë e barabartë, gjë që evidencat nuk e kanë dëshmuar. Për shembull listat që kemi marr tregojnë se vetëm pesë kandidatët e parë me pikë të barabarta janë emëruar përfitues. Nga mostrat e testuara në AZHB, nuk ka pas shënime për shqyrtimin e ankesave në ato dosje. Përderisa, dëshmitë e dërguara tani me komente, janë dëshmi për shqyrtimin e ankesave për rastet që nuk janë testuar nga ne, nuk ka qenë mostër e përzgjedhur.

Komisioni për shqyrtimin e ankesave emrohet me vendim nga Sekretari i Përgjithshëm i MBPZHR-së. Ky komision i përbëhet nga tre anëtarë të MBPZHR-së dhe dy anëtar të AZHB-së. Anëtarët e komisionit janë të pavarur dhe marrin vendime sipas vullnetit të tyre të lirë dhe profesional, duke zbatuar aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ndërsa sa i përket çështjes së ankimimit ajo mbetet në përgjegjësin e aplikuesit të refuzuar ai ka të drejtën e ankimimit nga data e refuzimit deri në 30 ditë për ta paraqitur anëkesën e tij. Komisioni i emëruar me vendim sipas U/A konsiderohet komision profesional ku çdo vendim i tyre zbatohet në përputhshmëri me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ndërsa procesi i ankimit ndaj vendimeve të komisionit bëhet vetëm në gjykatën kompetente.

BARAZIA GJINORE DHE  
FUQIZIMI I GRAVE NGA ZONAT  
RURALE PËRMES PËRFSHIRJES  
SË TYRE NË TREGUN E PUNËS





Zyra Kombëtare e Auditimit  
Lagjja Arbëria  
Rr. Ahmet Krasniqi, 210  
10000 Prishtina  
Republika e Kosovës

